



PROCESVERBALI

Nga mbledhja e rregullt e Kuvendit Komunal të Rahovecit, e mbajtur më **26.09.2018** me fillim në ora **10.15**. Mbledhjen e kryesoi Kryesuesi i Kuvendit z. **Afrim Dina**. Konstatohet se kuorum për mbajtjen e mbledhjes kemi.

Kryesuesi – Përshëndetje për kryetarin e komunës z. Smajl Latfi, nënkryetarin e komunës z. Fatmir Iska, për monitoruesit e LMT-së, monitoruesit e OSBE-së, SHL-Kosova, profesororeshën së bashku me nxënësit e shkollë së mesme “Selajdin Mullabazi – Mici”, që sot i kemi prezent, përfaqësuesit e mediave, drejtorët e drejtorive komunale, delegatët e kuvendit komunal dhe gjithë të pranishmit. Në nderim dhe respekt të kolegut tonë z. Astrit Thaqi, i cili më nuk është në mesin tonë, ju ftoj për një minutë heshtje. Besoj se rendin e ditës dhe materialin e keni marrë me kohë? Për këtë mbledhje propozoj këtë:

 REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E RAHOVECIT - OPŠTINA ORAHOVAC
Drejtoria për Administratë të përgjithshme
Odeljenje za Opštu Upravu

REND DITE

1. Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
2. Pyetjet dhe përgjigjet në pyetjet e kuvendarëve,
3. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim vendimit të Kryetarit të Komunës, që të jepet pëlqimi për iniciimin e procedurës për shpronësimin e pronës së paluajtshme private për hapjen e rrugës publike,
4. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim vendimit të Kryetarit për marrjen e vendimit për shpalljen me interes të përgjithshëm publik P-71510008-00268-1,
5. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim vendimit të Buxhetit si dhe KAB-it për vitin 2019 – 2021,
6. Informatë nga DKA-ja për fillimin e vitit të ri shkollor 2018/2019.

-III- Nr. i prot. **2915** Më **26-10-2018**
Br. prot. Dt. **26-10-2018**
RAHOVEC - ORAHOVAC

Kryesuesi – A ka të shtoj dikush diçka sa i përket rendit të ditës, nëse jo atëherë e qes në votim rendin e ditës: Konstatohet se në mënyrë unanime është aprovuar rendi i ditës. Kalojmë në pikën e parë të rendit të ditës:

1. Aprovimi i Procesverbalit nga Mbledhja e Kaluar.

Kryesuesi – A ka dikush ndonjë vërejtje apo ndonjë sugjerim sa i përket procesverbalit nga mbledhja e kaluar, nëse jo e qes në aprovim procesverbalit nga mbledhja e kaluar: Konstatohet se në mënyrë unanime është aprovuar pika e parë (1), e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e radhës:

2. Pyetjet dhe përgjigjet në pyetjet e kuvendarëve.

Kryesuesi – A ka ndonjëri nga drejtorët që nuk ju është përgjigjur pyetjeve nga mbledhja e kaluar, nëse ka atëherë mundeni të dilni që të ju përgjigjeni pyetjeve të parashtruara nga kuvendarët, nëse jo atëherë fjalën e keni ju kuvendarë që të parashtroni pyetje ekzekutivit.

Dervish Çadraku – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, e kam një pyetje për kryetarin e komunës, i nderuar cili ka qenë ose cili është qëllimi i prishjes së objektit ose shtëpisë së madhe që e kemi quajtur në fshatin Ratkoc, unë e identifikoj Ratkoci me atë objekt. Ky objekt ka një histori dhe një të kaluar, për mendimin tim ka qenë gabim prishja e këtij objekti.

Vahid Krasniqi – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, në mbledhjen e kaluar e kamë bërë një kërkesë për një komisioni për emërtim të rrugëve, rrugicave dhe shesheve, dua ta di a është ndërmarrë diçka rreth këtij komisioni.

Fehmi Cena – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, desha të bëjë një pyetje sa i përket drejtorisë së shëndetësisë, ka disa javë që një kompani është duke punuar në QKMF dhe në fshatin Xërxë ku është duke i bërë disa renovime. Punimet në fshatin Xërxë nuk e di se si janë duke shkuar, por në Rahovec nuk janë duke shkuar punimet mirë, është kërkuar nga ne që ta lirojmë objektin e QKMF-së, ku jemi transferuar në objektin e emergjencës, por kur jemi kthyer në objektin e QKMF-së kemi parë që punimet nuk janë kryer as gjysma, lyerja e mureve është kryer, por dyshemeja nuk është kryer. Ne në një mbledhje paraprake kemi kërkuar pikërisht që të na bëhen këto renovime sepse dyshemeja është dëmtuar shumë, prandaj po ju njoftoj që punët nuk janë kryer mirë.

Mirjeta Krasniqi – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, do e përsërisë edhe në këtë mbledhje pyetjen të cilën e kam parashtruar në mbledhjen e kaluar, kur do të filloj shpërndarja e subvencioneve nga qeveria dhe komuna, për dëmet që janë shkaktuar bujqve në komunën tonë.

Refki Kryeziu – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, do ju përcjelli një shqetësim të banorëve të fshatit Gexhë, shtrati i lumit të Drinit të Bardhë është ngushtuar tek ura e shenjtë, saktësisht tek vendi që ne e quajmë brana, gjatë të reshurave atmosferike shtrati i lumit është duke u rritur dhe si pasojë e kësaj ujërat e zeza të shtëpive të këtij fshati janë duke u kthyer mbrapa përmes gypave të kanalizimeve që janë duke u derdhur tek lumi i Drinit të Bardhë. Prandaj kërkojnë mundësisht që tek vendi i quajtur brana, të mirën masat e duhura që të zgjerohet ky shtrat, në mënyrë që banorët e këtij fshati të mos e kenë më këtë problem.

Masar Popaj – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, deri sa në mbledhjen e kaluar kolegu z. Faton Ramadani diskutoj rreth ndriçimit publik në fshatin Celin, i cili është duke qëndruar i ndezur gjatë 24 orëve, ndërsa kolegu z. Ali Zhuniqi e tha se në Fortesë fare nuk ka drita të ndriçimit publik. Të nderuar ka dy muaj që ndriçimi publik në fshatin Fortesë nuk është duke punuar, pres nga ju që të më tregoni se ku qëndron ky problem.

Trajko Shariq – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, arsyeja pse e kam mare fjalën është rreth shqetësimit të banorëve të fshatit Hoçë e Madhe, arsyeja është vjedhjet të cilat kanë ndodhur, ku janë vjedhur vetura dhe kafshët shtëpiake, gjegjësisht lopë dhe viça. Banorët e Hoçës së Madhe kohëve të fundit nuk janë duke u ndier bash të sigurtë për shkak të ngjarjes së fundit.

Samir Mustafa – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, sa i përket pyetjes që e parashtrroi z. Fehmi cena, i nderuar ne kemi një kontratë për renovimin e objekteve shëndetësore, repartit i mjekësisë familjare pothuajse është gati i përfunduar, këtu na ka mbetur vetëm edhe një pjesë e dyshemesë. Arsyeja pse nuk është shtruar dysheme në repartin e mjekësisë familjare është sepse operatori nuk ka mundur të gjej parketin e njëjtë, por besoj se brenda javës edhe kjo do të kryhet. Po ashtu janë duke vazhduar renovimet e objekteve të AMF-ve tjera si në Xërxë, Fortesë, Krushe të Madhe dhe Ratkoc.

Përparim Krasniqi – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, sa i përket ndriçimit publik, ju njoftoj zyrtarisht që kemi lidhur kontratën për ndërtimin e ndriçimit publik, sot vetëm do të fillojnë piketimet në fshatin Xërxë. Kurse sa i përket meremetimit të ndriçimit publik, ka pasur një ankesë në prokurim, dje ka përfunduar ankesa dhe kontrata lidhet nesër, në momentin që e kërkojmë planin dinamik të punëve për meremetimin e të gjitha këtyre problemeve dhe shqetësimeve, si në Fortesë, Celinë dhe vendbanime të tjera ku nuk ka ndriçim publik, besoj se brenda një muaji do të rregullohen të gjitha problemet rreth ndriçimit.

Kryetari – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, i nderuari z. Dervish çardaku, ne kemi lidhur tashmë një kontratë e cila ka filluar që të zbatohet, ku parashihen që të rrënohen një listë me objekte. Objektet që do të rrënohen janë ato të cilat nuk i plotësojnë as kushtet minimale për të qëndruar ashtu siç janë, për arsye se janë të vjetra dhe nuk ja vlen që të investohet në meremetimin e tyre, ato janë objektet të cilat janë pa leje dhe objektet të cilat paraqesin rrezikshmëri të lartë për qytetarët të cilët kalojnë andej pari. Kemi rrënuar shkollën e vjetër në fshatin Kramovik, pasi që ekziston shkolla e re, kemi rrënuar ish stacionin famëkeq të

milicisë serbe në Ratkoc, i cili ka histori të errët, ky objekt përveç historisë së keqe që ka për atë zonë, po ashtu ka rrezikuar edhe jetën e qytetarëve sepse aty është bërë një strehë jo vetëm për qentë endacak por edhe për shumë gjëra tjera. Ne i kemi ndjek procedurat, ju kemi drejtuar agjensionit të menaxhimit të emergjencave, sepse siç e dini ajo është pronë e komunës së Rahovecit, por ka qenë në menaxhim të agjensionit për menaxhimin e objekteve AMO, i cili është një institucion në kuadër të MPB. Po ashtu kemi rrënuar edhe objektin që ndonjëherë ka qenë edhe strehë e banimit për qytetarët të cilët nuk kanë jetuar në atë zonë, në vitet e 90-ta ka qenë edhe shkollë e mesme paralele e ndarë qendrës së arsimit të mesëm të orientuar në atë kohë Ramiz Sadiku, ku edhe vetë i kam kryer dy vite shkollë aty, ka qenë pastaj edhe zyra e vendit në këtë objekt, kanë qenë edhe zyrat e partive politike, ka pasur edhe aktivitet të cilat janë zhvilluar pas lufte. Ne për këtë objekt e kemi bërë një incizim të gjendjes dhe na ka dalë që nuk ka asnjë llogari që të hymë me ndonjë plan të meremetimit, për arsye se duhen investime shumë të mëdha për diçka që nuk ja vlen. Kam marrë pjesë direkt në vendin e ngjarjes kur është bërë shembja e këtij objekti dhe e kam parë vetë se sa ishte i fortë ky objekt, ne kemi menduar se ky objekt i ka 2 m muret e gjëra por nuk i kish pas ashtu. Ne e dimë se ky objekt është ndërtuar me djersën e punëtorëve, unë këtë nuk mbajë mend, besoj që as z. Dervish Çadraku nuk e mban mend sepse është ndërtuar bukur herët. Sa i përket asaj se çka do të bëhet tani në atë pjesë, ne së pari do të mbajmë një dëgjim publik me qytetarë, por për një jam shumë i sigurtë që nuk do të ketë uzurpime të pronës sepse prona është komunale, por do të planifikohet diçka që i përgjigjet realitetit dhe interesit të banorëve të asaj ane. Ne do të vazhdojmë rrënimin e ish shkollës së vjetër në fshatin Opterushë, edhe kjo shkollë paraqet histori jashtëzakonisht interesante për gjithë banorët e këtij fshati, mësimdhënësit etj. Por në këtë objekt duhet që të rrënojmë sepse ajo mbahet me disa shtylla nga druri. Po ashtu do të rrënojmë edhe objektin në fshatin Zoqishtë, i cili ndoshta ka 70 vite që ekziston, po ashtu në listën e rrënimeve janë edhe disa objekt pa leje si në qytet ashtu edhe në fshatra, drejtori i inspektoratit e ka listën e projekteve të parapara për tu rrënuar. Mendoj se procesi është duke shkuar në rregull, por për me ndreq diçka mirë mendoj se duhet me prish diçka që nuk i plotëson as kushtet minimale. I nderuari z. Refki Kryeziu sa i përket pastrimit të lumit Drini i Bardhë, përkatësisht tek diga për arsye se kanë shqetësim banorët e fshatit Gexhë. I nderuar edhe tek ne ka ardhur ky shqetësim nga disa banorë, por ne duhet që të ju informojmë juve se lumenjtë janë pasuri shtetërore dhe kombëtare të rregulluara me ligj, ne që të kemi të drejtën që të hyjmë në veprime të tilla si tek diga, duhet që të kalojmë nëpër shumë filtra, pastaj është përgjegjësi e jona që të kërkojmë sqarime, masa dhe veprime në atë drejtim nga Ministria e Planifikimit Hapësinorë dhe e Mjedisit, po ashtu edhe nga ministrinë e tjera përkatëse të cilat kanë përgjegjësi në këtë drejtim. Por ne si komunës realisht nëse shkojmë ta pastrojmë mundemi që të dënohemi, ajo që ne mundemi të bëjmë është se së bashku me kryetarin e komunës së Gjakovës të kujdesemi për këtë shqetësim, sepse edhe tek ai ka shqetësime për këtë dikë e cila ka filluar të vetë shkatërrohet. Por sido që të jetë ju premtoj se ne do të kujdesemi së bashku me drejtorin z. Përparim Krasniqi dhe z. Rumir Zhuniqi, që të i adresohemi Ministrisë së Planifikimit Hapësinor dhe Mjedisit dhe ministrive të tjera përkatëse. Përndryshe ne e kemi dërguar një projekt në BERZH, dhe do të shohim se a do të mundet që kjo kërkesë legjitime të adresohet përmes një projekti të veçantë që nënkupton trajtimin e lumit që e përshkon komunën tonë dhe më tutje. E nderuara znj. Mirjeta Krasniqi, kur është marrë vendimi nga qeveria e republikës së Kosovës nuk është përmendur muaji shtator por muaji tetor, tani a do të filloj në fillim të tetorit zbatimi i këtij vendimi, a do të ja filloj në rastin e ridestinitimit të mjeteve, sepse këtë vite rishikim të buxhetit nuk ka pasur, tash kur do ja filloj në muajin tetor në fillim, në mes apo në fund të muajit për këtë nuk jam i sigurt. Këtë çështje e kam ngritur edhe një herë me ministrin e bujqësisë jo më shumë se një javë, ku e kemi ngritur ekskluzivisht edhe këtë çështje se kur do të filloj implementimi i vendimit, por shpresat janë që kjo kërkesë të filloj të përmbushet gjatë muajit tetor. Sa i përket vjedhjeve të bagëtive në lokalitetin e Hoçës së Madhe, në fillim të muajit do e mbajë një mbledhje me anëtarët e KKS-së, ku do të kërkojmë sqarim nga policia përkitazi me vjedhjet të cilat janë duke ndodhur jo vetëm në Hoçë të Madhe, por edhe në disa lokalitete tjera të komunës sonë. Besoj se këto janë shqetësime me vend, ne jemi të interesuar që mos të kemi fare veprime të tilla në

komunën tonë, prandaj do të kërkojmë nga policia që të jetë më efikase në punën e tyre. Sa i takon komisionit për emërtim të rrugëve, besoj se në mbledhjen e ardhshme të kuvendit të komunës do ti propozoj kuvendit që të formojnë një komision, i cili do të shqyrtoj gabimet ose lëshimet të cilat kanë ndodhur në këtë proces, por sigurisht se do të i shqyrtoj edhe kërkesat dhe shqetësimet, nevojat dhe nominimet për emërtime ku nuk janë të emëruara. Ne kemi një dosje, unë vetëm e kam autorizuar drejtorin e urbanizmit që ta rivendos komunikimin me përgjegjësit në ministrin përkatëse.

Afërdita Thaqi – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, po e ngris një shqetësim nga fshati Çifllak, në objektin e shkollës fillore të këtij fshati kur është rinovuar kulmi i shkollës është hequr rrufepritësi, dhe që nga ajo kohë nuk është vendosur më, nxënësit rrezikohen çdo ditë. Për këtë shqetësim është njoftuar edhe drejtori i DKA-së, prandaj ju kisha lutë që sa më shpejtë të rregullohet kjo punë, sepse jeni në dijeni se këtë vit nga rrufeja komuna jonë ka pasur edhe humbje jete.

Besmire Bytyqi – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, pyetje ime i drejtohet kryetarit të komunës, i nderuar sa mundeni të ndikoni në Qeverinë e Republikës së Kosovës, përkatësisht në Ministrin e Infrastrukturës, nëse keni kaluar në rrugën Rahovec – Suharekë, ka një muaj që kjo rrugë është në një gjendje jo të mirë. Prandaj a kishit mundur ju të ndikoni që kjo rrugë të asfaltohet sa më shpejtë të jetë e mundur.

Kryetari – Sa i takon kulmit të shkollës fillore në fshatin Çifllak, në këtë shkollë ka punuar një kompani e cila nuk ka mundur me e krye punën, për arsye se nuk ka mjete financiare, kjo kompani quhet ISA – DEKOR, ne si komunë kemi mjaftë vërejtje në kualitetin e punëve që i ka bërë kjo kompani. Edhe ne i kemi dëgjuar shqetësime të plotë banorëve për këtë që ju e thatë sot, shpresojmë se do të mundemi ta fusim në punë këtë kompani sepse ajo po na ankohet se nuk ka mjete, kurse projektin për meremetimin e shkollave ajo e ka bukur të madh, por mendoj se veprimet të cilat ai i ka bërë gabim duhet që ti përmirësoj. Kurse sa i përket çështjes së rrugës Rahovec – Suharekë, është e vërtetë se ky projekt është nga Ministria e Infrastrukturës, ne si komunë kemi vërejtjet dhe kresat tona, të cilat nuk i bien përshtati kontratës ekzistuese, sepse ne kemi kërkuar zgjerim të rrugës, rruga ekzistuese është 6 m e gjerë kurse ne kemi kërkuar që ajo të jetë 7 m. Pastaj me anë të kërkesës sonë është futur si projekt shtesë që në ato vende ku ka mundësi të jetë edhe shiriti i tretë shtesë, sepse nëse ne e lëmë që ata vetëm ta shtrojnë me asfalte rrugën ashtu siç është, mendoj se pastaj pas 10 viteve do i bie në mend për të zgjeruar. Ne e dimë që në këtë pjesë është zona ekonomike, pastaj kjo rrugë i lidhë dy komuna, pastaj janë edhe disa vendbanime në këtë rrugë. Prandaj ne jemi duke u përpjekur që të nxjerrim maksimumin nga një kontratë e cila është e pamjaftueshme, ajo që na gëzon neve është se ne nuk kemi ndonjë problem me prona, të gjitha janë prona komunale, unë i kam kërkuar drejtorit të shërbimeve publike që së paku deri tek fshati Samadraxh, ne të i bëjmë ato veprime tona për zgjerim të rrugës. Mendoj e nderuar se janë afër finales së këtij projekti dhe shpresoj se sa më shpejtë do të asfaltohet kjo rrugë.

Dervish Çadraku – Mendoj se me mbeti pak borxh kryetari, nuk dëshiroj të keqkuptohemi sepse unë jam kuvendarë i kuvendit komunal, dhe përveç mendimit tim unë e shpreh edhe mendimin e shumë qytetarëve të tjerë. Ky objekt e ka një trashëgimi kulturore është i ndërtuar diku në vitet e 50-ta, po ashtu edhe si objekt arkitektonik ka qenë i vlefshëm, ajo që nuk mora përgjigje është se aktivitet i kujt ka qenë ky, sepse ndoshta ka qenë më mirë që kjo të kalojë përmes kuvendit sepse është një objekt i një rëndësie të veçantë, në këtë mënyrë do ishte marrë mendimi i kuvendarëve. Kurse sa takon konstruksionit ka qenë objekt i fortë, mendoj se ka mundur të përdoret për diçka tjetër me një ndërhyrje, kishte mundur të shfrytëzohet për zyre të bizneseve dhe për diçka tjetër, dhe po ashtu kishte do të qëndroj ky objekt si një arkitekturë e vjetër.

Kryetari – Për sa i takon opinionit të qytetarëve të Ratkocit dhe të asaj zone, ne jemi moti në politik sikurse unë ashtu edhe z. Dervish Çadraku dhe plotë prej nesh që jemi sot këtu prezent. Ka pasur plotë kërkesa që të veprohet në drejtim të këtij objekti, ka pasur tendenca për incizim të gjendjes në kohën e z. Vepai, por besoni se nuk ja ka vlejtur që të bëhen investime në këtë objekt sepse nuk do të na shërbejnë neve që ti arsyetojmë ato investime. I kam më shumë se 1300 vota në Ratkoc, dhe në ditën kur është bërë rrënimi i

këtij objekti kam marr pjesë, dhe kënaqësia e qytetarëve ka qenë s emirë, plotë njerëz atë ditë janë gëzuar që është duke u rrënuar ky objekt. Ajo që duhet të bëhet tani është ne duhet që të bisedojmë edhe këtu, por edhe në fshat se çka do të bëhet tani në atë hapësirë e cila tani është duke marrë më mirë frymë. A është monument i trashëgimisë, përgjigje ime është po, por nëse është kështu atëherë ne plotë shpija të vjetra sikurse që e kishte edhe vetë z. Dervish Çadraku të cilën e ka prishur për ta ndërtuar të re, arsyeja pse e ka prishur është sepse nuk i ka plotësuar kushtet për të qenë objekt, prandaj edhe investimet për ta sjellë në një standard normal këtë objekt kishin me qenë jashtë zakonisht të mëdha dhe nuk do ja vlente. Por ne do të kujdesemi që në hapësirat e tilla të kemi projekte të cilat do ti përmbushin kërkesat e qytetarëve, por edhe diçka që do të jetë e bukur për sytë e gjithë atyre që do të kalojnë andej pari.

Fehmi Cena – Do ndërlihem shkurtë sa i përket rrënimit të këtij objekti, ne për herë të parë jemi duke dëgjuar sot se ky objekt qenka rrënuar, për këtë e ndaj mendimin e njëjtë me z. Dervish Çadrakun, nëse ky objekt sikurse edhe objektet tjera janë në trashëgimi kulturore historike nuk do të duhej të rrënohen në këtë mënyrë. Së paku është dashur të mbahet një debat publik ose të jetë si pikë e rendit të ditës në kuvend, kështu si është rrënuar për mua është gabim. Pastaj i nderuar kryetar ju keni fituar vota dhe jeni kryetar i komunës, por nuk e kemi dëgjuar që gjatë fushatës të keni cekur diku se nëse bëhem kryetar do ta rrënoj këtë objekt. Objektet që janë të trashëgimisë kulturore ose ato që dëshirojmë ne të i vlerësojmë sepse ka objekte që meritojnë të jenë në këtë grup por nuk është punuar mjaftueshëm, në Rahovec ka mjaftë shtëpi që do të duheshin të jenë në mbrojtjen e trashëgimisë kulturore, dhe nëse hynë atëherë rrënimi i tyre nuk mundet të bëhet në këtë mënyrë si është bërë rrënimi i këtij objekti, por duhet që të bëhet debat patjetër me qytetar dhe një mbledhje në kuvend.

Kryetari – Për mua është e pakuptueshme pse po harxhoni kaq shumë kohë rreth një teme e cila edhe ashtu ka përfunduar. Pastaj i nderuar nuk e thash që është në listën e objekteve të trashëgimisë kulturore, nuk është dhe kur nuk ka qenë, por në mendjen tonë ka trashëgimi, ka ndjenja të përziera. Pastaj mos harrini se ne i kemi ndjek procedurat, pra gjithçka është në pajtim me ligjin, nëse është në kundërshtime ligjin mos e mbani gjallen ju sepse ata do të më drejtohen mua e jo juve. Sa i takon asaj a kam premtuar apo jo, e kam thënë, më ka shpëtuar në mandatin e kaluar, qytetarët e komunës së Rahovecit e dinë këtë, madje ata kanë kërkuar që ta lirojnë edhe objektin që e kanë meremetua për zyre të vendit, sepse nuk është bash në pozitën e mirë, ju kam thënë edhe atëherë po ju them edhe tani. Objekti ku sot është zyra e vendit për arsye se ky kuvend ka vendos që të investoj në këtë objekt për meremetim nuk kam mundur, sepse përndryshe edhe ai kishte me hy në listën e objekteve për rrënim, për arsye se lirimi i hapësirave publike ndonjëherë dominon. Listën e objekteve me trashëgimi e kemi ne, po ashtu e ka Ministria e Kulturës dhe instituti i për mbrojtje të monumenteve, në këtë listë as që ka qenë dhe nuk ka pasur asnjë arsye me qenë një objekt i cili ka histori edhe të mirë, por ka histori edhe të dhimbshme. Nëse mendoni kështu atëherë edhe objekti i stacionit të milicisë në Ratkoc i cili është rrënuar ka histori të trashëgimisë, në këtë stacion kemi periudhën e errët, ku njerëzit janë rrahur keq për vdekje, por po ashtu kemi edhe periudhën e lavdishme kur UÇK-ja e ka marr këtë stacion. Pra në një pikëpamje edhe ky është objekt i trashëgimisë sepse ka histori, por në këtë objekt mbas lufte gjithçka është bërë, kjo ka qenë kërkesë permanente edhe në adresë të qeverisë time dikur, po ashtu edhe në adresën e qeverisë Vehapi, por për arsye se agjensioni për menaxhimin e emergjencave nuk ka dhënë shpjegim se çka duhet të bëhet, z. Vehapi nuk është ngutur që të rrënojë këtë objekt, për arsye se agjensioni nuk ka dhënë përgjigje, kurse ne ju kemi rikthyer edhe një herë këtë temë ku kemi marrë përgjigje për rrënim. Ky është shpjegim i vetëm që mundem me ju dhënë të nderuar.

Kryesuesi – Ju faleminderit të gjithëve për diskutimin e zhvilluar, kalojmë në pikën e radhës:

3. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim vendimit të Kryetarit të Komunës, që të jepet pëlqimi për iniciimin e procedurës për shpronësimin e pronës së paluajtshme private për hapjen e rrugës publike.

Afrim Oruçi – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, këtu kemi të bëjmë fjalë për zonën kadastrale në Rahovec, pronë private ku janë bashkëpronarë 4 persona, z. Zijadin Durgut, Selajdin Durguti, Bahrije Durguti dhe Jalldëze Durguti. Kjo parcelë i ka 1 ari e 15m², kemi të bëjmë me hapje të rrugës publike edhe

pse rruga është shtruar në mes të vitit 2014-2015, për me qenë më i qartë kjo rrugë është quajtur 28 nëntori, tani e ka emrin Ibrahim Rugova, palët kanë bërë kërkesë në Drejtorin e Gjeodezisë dhe Kadastrës edhe në vitin 2015, ku po ashtu të njëjtën kërkesë e kanë bërë edhe në vitin 2017, me arsyetimin se kërkesa e vitit 2015 nuk ekziston më dhe është kërkuar nga palët që ta ri procedojnë edhe një herë kërkesën. Kjo parcelë në mandatin e kaluar është shpallur si interes i veçantë, pasi që rruga është në interes të përgjithshëm. Qëllimi i kërkesës drejtuar juve është për dhënie të pëlqimit për shpronësim të pronës së paluajtshëm, ne i kemi edhe tre parcela private që shtrihen përkaj kësaj rruge, ku dy palët e tjerë kanë pritur mjaftueshëm për kompensim, pastaj ju janë drejtuar gjykatës, një palë e ka fituar lëndën në shkallën e parë, ku pastaj ju janë drejtuar përmbauesit për ti realizuar kompensimin e mjeteve. Ne si komunë përveç që jemi të obliguar të ja paguajmë kompensimin për pronë, duhet që ti paguajmë edhe shpenzimet gjyqësore të gjykatës dhe shpenzimet e përmbauesit. Në atë kohë palëve në fjalë ju janë drejtuar me fjalë, mos na pengoni në shtrimin e rrugës, pasi të përfundoj shtrimi i rrugës pastaj do ju bëjmë shpronësimin, por kjo deri më tani nuk ka ndo shur. Kërkojmë nga ju që pas shqyrtimit ta mbështesni këtë propozim vendim.

Rasim Fazliu – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, në KPF kemi diskutuar rreth kësaj pike, po ashtu jemi njoftuar me këtë çështje, prandaj ne si grup i PDK-së jemi pro këtij propozimi që të bëhet shpronësimi i kësaj parcele. Arsyet pse po e përkrahim janë të shumëfishta, e parë sepse kjo rrugë tani është funksionale, pastaj pronarëve të kësaj parcele ju është premtuar se pasi të ndërtohet rruga do ju bëjmë shpronësimin. Kjo rrugë do ju shërbej qytetarëve të komunës së Rahovecit, po ashtu është e drejtë që pronarëve të ju bëhet kompensimi i për pronën në fjalë. Por ajo që mua më shqetëson është se ky ndoshta nuk do të jetë rasti i parë dhe i fundit, sepse problemet rreth shpronësimit do të ketë shumë në të ardhmen, pastaj do të duhet që gjithkund ku paraqitet nevoja për shpronësim të i kryhet procedura.

Fehmi Cena – Ne në KPF këtë pikë nuk e kishim shumë të qartë sepse lënda nuk ishte e kompletuar, ne kemi kërkuar një skicë shtesë nga drejtori, dhe shumë mirë që na ka sjellë këtë skicë, kishte me qenë mirë që herrave të tjera kur të shtrohen kësi çështje rreth shpronësimit të pronave private për interes publik, ne si kuvendarë kur të i lexojmë të i kemi të qartë. Tani jemi duke parë që kjo ka të bëjë me një rrugë publike, prandaj mendoj se kjo kërkesë është në interes të përgjithshëm dhe jemi pro që të kalojë ky propozim vendim.

Dervish Çadraku – Edhe ne si grup mendojmë se është i arsyeshëm ky propozim vendim, por ajo që nuk e kam të qartë është: pse qeveria e kaluar nuk i ka kryer këto veprime, pastaj a kanë qenë në gjykata këto kërkesa, si është rezultati i krejt kësaj, nuk e kuptova më herët kur e shpjegoi drejtori. Pastaj kush ka qenë iniciatori që kjo punë tani të kryhet, palët apo është diçka që duhet të ndodhë patjetër sepse rruga nuk është legjitime.

Ali Morina – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, ne si grupe i AAK-së e kemi shqyrtuar me kujdesë këtë propozim, prandaj i japim mbështetje të plotë këtij propozim vendimi.

Munib Durguti – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, e përshëndes faktin se kjo punë është duke u kryer në mënyrë procedurale, ngase tash e disa vite kjo rrugë është duke u shfrytëzuar nga qytetarët, nuk është gjë e mirë që nuk kemi një rregullim procedural për kompensim të palëve. Ajo që dua të cekim është se këta pronarë edhe në të kaluarën qeveria i ka premtuar se do i kompensoj, ne sot jemi të thurur që të marrim një vendim për shpronësim dhe të njëjtën kohë për kompensim, por ne nuk kemi aty afër asnjë pronë të përshtatshme për ti kompensuar këta palë. Nuk është aspak e tepërt edhe në aspektin ligjor që kur të ofrohen propozim vendime të tilla që në një pikë të vendimit ceket edhe kompensimi me pronë të caktuar, ose kompensimi në të holla. Mendoj se kështu do të ishte kryer një lëndë një herë e mirë, e jo si sot që ne jemi duke vendosur për shpronësim, kurse në një mbledhje tjetër për kompensim, përndryshe jam pro këtij propozim vendimi.

Afrim Oruqi – Sa i përket pyetjes se a ka tentuar pala të i drejtohet gjykatës, nuk kanë tentuar i nderuar sepse palët në fillim të mandatit na kanë takuar neve, ku kemi biseduar me ta dhe i kemi kërkuar që të na japin kohë që të përgatisim materialin dhe të shohim se si janë mundësitë financiare. Kurse sa i përket palës

tjetër që është në kufi me këtë pronë, pala ju ka drejtuar gjykatës, ku në shkallë të parë e ka fituar lëndën, ju garantoj se edhe këta do ta kishin fituar lëndën. Qëllimi i politikave tona është që me këto mjete buxhetore që i kemi të i kompensojmë, këtë vit i kemi të paraparë 50,000.00 €, po ashtu i kemi paraparë edhe për vitin e ardhshëm, qëllimi ynë është që mos të paguajmë shpenzimet e gjykatave dhe përmbaruesve, por të i shpronësojmë me kohë me këto mundësi financiare që i kemi. Edhe këtyre palëve që jemi duke biseduar ju është premtuar që do i bëhet shpronësimi, vetëm një herë të i lejojnë që ta asfaltojnë rrugën, por nuk është përmbushur premtimi i dhënë, por nuk do të thotë që në të ardhmen nuk do të përmbushet.

Kryesuesi – E qes në votim propozim vendimi i Kryetarit të Komunës, që të jepet pëlqimi për iniciimin e procedurës për shpronësimin e pronës së paluajtshme private për hapjen e rrugës publike: Konstatohet se në mënyrë unanime është aprovuar pika e tretë (3) e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e radhës:

4. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim vendimit të Kryetarit për marrjen e vendimit për shpalljen me interes të përgjithshëm publik P-71510008-00268-1.

Afrim Oruçi – Këtu kemi të bëjmë me shpallje të interesit publik P- 71510008-00268-1 në zonën kadastrale Hoçë e Madhe, qëllimi i vetëm i shpalljes së interesit të përgjithshëm të kësaj zone është, ruajtja, mbajtja dhe rritja e vlerës së kësaj parcele e cila është me një sipërfaqe më shumë se 3 hektar, kjo parcelë është përkaj rrugës Rahovec – Suharekë, më konkretisht në kufi me fabrikën e kartonit. Sipas politikave qeveritare jemi duke tentuar që çdo parcelë komunale shtetërore në nivel të komunës të i shpallim në interes të përgjithshëm, qëllimi i vetëm është rritja e vlerës dhe ruajtja e këtyre pronave nga uzurpimet. Ftoj kuvendarët që pas shqyrtimit ta përkrahin këtë propozim vendim për shpallje të interesit të përgjithshëm.

Rasim Fazliu – Ne si grupe i PDK-së jemi pro këtij propozimi që parcela me sipërfaqe më shumë se 3 hektar të shpallet interes i përgjithshëm, sepse qëllimi është i mirë për ruajtjen e pronës komunale.

Ali Morina – Ne si grupe i AAK-së dhe i NISMËS, e mbështesim këtë propozim vendim të kryetarit.

Kryesuesi – E qes në votim propozim vendimin e Kryetarit për marrjen e vendimit për shpalljen me interes të përgjithshëm publik P-71510008-00268-1: Konstatohet se në mënyrë unanime është aprovuar pika e katërt (4), e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e radhës:

5. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim vendimit të Buxhetit si dhe KAB-it për vitin 2019 – 2021.

Fehmi Cena – Ne si grupe i LDK-së jemi duke kërkuar një pauzë prej 10 minuta para se të kalojmë në diskutim për këtë pikë të rendit të ditës, kërkoj që këtë propozim ta mbështesin edhe kuvendarët e tjerë.

Kryesuesi – Të nderuar z. Fehmi Cena propozoi që të kemi një pushim të shkurtër dhe pastaj të ktheheni për diskutimin e pikës së radhës. Të nderuar pas 30 minutave pushim ju lus që të ktheni në sallë për të vazhduar me mbledhje. Të nderuar kuvendar po vazhdojmë me mbledhje, kuorum për vazhdim të mbledhjes kemi. Ftoj zyrtarin për financa z. Arben Sokoli që të prezantoj KAB-in për vitin 2019-2021 si dhe buxhetin për vitin 2019, pasi që drejtori i financave z. Afrim Limani nuk ka mundur që të merë pjesë në këtë mbledhje, të gjithë jeni të dijeni se cila është arsyeja e mos prezencës së tij.

Arben Sokoli – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, z. Arben Sokoli prezantoi para kuvendarëve KAB-in 2019-2021 dhe projekt buxhetin për vitin 2019, ku ceku se KAB-i 2019-2021 është bazuar në qarkoren 01/2018 dhe 02/2018, e cila ka dalë nga Ministria e Financave dhe sipas rekomandimeve të KPF-së, si dhe në bazë të kërkesave të qytetarëve të cilat kanë rrjedhur nga debatet publike të cilat janë zhvilluar nëpër lokalitete e komunës së Rahovecit. Buxheti për vitin 2019 është: 13,658,891.00 €, po ashtu zyrtari në fjalë ceku se shpërndarja e buxhetit në kategori ekonomike për komunën e Rahovecit për vitin 2019 përfshinë: paga dhe mëditje vlera 7,435,669.00 € ose në përqindje 54.44 %, mallra dhe shërbime vlera 1,514,331.00 € në përqindje 12.96 %, shpenzime komunale vlera 255,500.00 € në përqindje 12.96 %, subvencione dhe transfere vlera 250,000.00 € në përqindje 1.83 %, investime kapitale vlera 4,203,391.00 € në përqindje 30.77 %.

Rasim Fazliu – Ne KAB-in për vitin 2019-2021 e kemi shqyrtuar në KPF, ku gjatë diskutimit i kemi dhënë disa rekomandime, por prezantuesi i KAB-it nuk na tregoi se a janë inkorporuar ato ndryshime që ne kemi kërkuar që të bëhen, nëse nuk janë bërë kishte me qenë mirë të na tregoi pse nuk janë bërë. Do

diskutoj tani rreth KAB-it 2019-2021, ne si grupe i PDK-së e kemi analizuar në mënyrë të detajuar KAB-in, konkretisht buxhetin për vitin 2019, ku kemi parë që shumë kërkesa të qytetarëve që kanë qenë nëpër dëgjime buxhetore janë futur në këtë buxhet, por po ashtu kemi edhe disa vërejtje që së bashku do i diskutojmë dhe nëse kemi gjuhë të përbashkët që ti përmirësojmë, sepse për këtë jemi edhe të thirrur këtu. Do të ndalem tek faqja nr.9, këtu ceket se të hyrat vetanake komunale kanë shënuar zvogëlim ose rrënje prej 29.17%, kurse prapë është duke u cekur se të hyrat vetanake të planifikuara zvogëlim nga viti 2019-2021 përafërsisht -24.28%, por ajo që nuk e kuptoj është se menjëherë pastaj ceket se kjo rritje kryesisht është koncentruar në të hyrat nga tatimi në pronë ku nga viti 2019 planifikohet të fillohet edhe tatimi i tokave, si dhe implementimi i taksës për mbeturina. Kjo për mua është një paqartësi sepse një anë thuhet se ka pasur rrënje, kurse në anën tjetër thuhet se ka pasur rritje, kjo mendoj se duhet që të përmirësohet. Në mallra dhe shërbime shihet se janë rritur dukshëm shpenzimet, por duhet të dimë se shuma është më e madhe. Konkretisht do të ndalem tek disa temat e tjera siç janë: Ne si grupe i PDK-së mendojmë se është mirë që të respektohen kontratat e lidhura në mes punëdhënësit dhe punëmarrësve me shumatat përkatëse të parapara sipas planit dinamik. Po ashtu kam një pyetje: Cili është plani i qeverisjes aktuale për menaxhimin e mbeturinave në buxhetin e viti 2019, gjegjësisht për mbledhjen e taksës së mbeturinave, shuma e cila është e caktuar të gjithë e dimë se nuk është e mjaftueshme karshi të dhënave që ne i kemi nga kompanitë që i mbledhin taksën e mbeturinave. Pastaj të nderuar kur bëhet fjalë për planin gjinorë, komuna nuk ka përgatitur një buxhet të përgjegjshëm të detajuar për këtë kategori, ne e kemi cekur më herët se ka plotë komuna që këtë çështje e kanë kryer, prandaj kishte me qenë mirë që edhe komuna jonë të bëjë një plan gjinor të detajuar. Do të diskutoj rreth projekteve të investimeve kapitale, ne si grup i PDK-së kërkojmë heqjen e disa projekteve që nuk i takojnë kategorisë së investimeve kapitale, dhe të njëjtat projekte të shkojnë në kategoritë e mallrave dhe shërbime dhe në subvencione. Të gjitha këto projekt që unë po flasë e kapin shumën prej 190,000.00 €, të gjithë ju e dini se ne kemi pasur vërejtje të mëdha nga auditori i përgjithshëm për arsye se janë bërë kapërcime nga një kategori ekonomike në kategorinë tjetër ekonomike, ku kemi marrë edhe një kualifikim mjaftë të keq për vitin e kaluar nga auditori i përgjithshëm, prandaj është mirë që ne së bashku të shqyrtojmë dhe të shohim se çka ka mundësi të bëhet në mënyrë që këto projekte të kalojnë në kategoritë përkatëse. Në KPF kemi thënë se projektet të cilat janë me emërtime të përgjithshme të jenë të detajuara dhe ne të dimë se për çka jemi duke votuar, pra të ceket se sa mjet ndahen për një rrugë p.sh në fshatin Apterushë, një në Kramovik etj, mendoj se nuk kemi se çka të mbajmë të fshehur as ju dhe as ne nga qytetarët. Do ju lexojë projekte një nga një në mënyrë që ta keni më të qartë, kemi projektin e ri Përkrahja e fermerëve në komunën e Rahovecit (Mekanizëm bujqësor, impute bujqësore, farëra, plehra kimike etj), kapë vlerën 30,000.00 €, ne si grupe mendojmë se ky projekt nuk duhet të futet investime kapitale por duhet të jetë në kategorinë e subvencioneve. Pastaj projekti tjetër i ri është: Përkrahja e projekteve për OJQ, për zhvillim rural, shuma është 20,000.00 €, edhe ky projekt duhet të jetë në subvencione e jo në investime kapitale, pastaj projekti tjetër është: Konsulencë për hartimin e projekteve për fermerë, shuma 30,000.00 €, ky projekt nuk duhet të jetë në investime kapitale por në shërbime. Të nderuar do të dalë me një propozim konkret nga grupi jonë i PDK-së, që këto projekte të reja që i keni paraparë të cilat nuk i takojnë kategorisë së investimeve kapitale, propozojmë që këto mjete prej 190,000.00 € të shkojnë në kanalin e kullimit të tokave në fshatrat Celinë – Fortesë – Xërxë, nëse bëhet kjo besoj se do të jemi dakord me buxhetin. Të nderuar koleg të grupit të PDK-së nëse diçka kam harruar të ceki, mundeni lirisht të merrni fjalinë që të më plotësoni.

Vahid Krasniqi – Tek kodi 43471- ndërtimi i rrugëve Xërxë, Celinë, Nashpallë, Senovc, Retij e Epërme dhe Mrasor, për vitin 2019 janë ndarë 50,000.00 €, ndërsa deri në vitin 2021 janë për këtë kod janë ndarë 180,000.00 €. E di që nuk munden të futen detajet në program, por kisha pas dëshirë që të më tregojë drejtori se në fshatin Senovc cila rrugë do të shtrohet, pasi që i di edhe saktë premtimet e kryetarit cilat kanë qenë. Tek kodi 43475- ndërtimi i rrugëve në Drenoc, Çifllak, Dejnë, Malësi e Vogël dhe Apterush, ceket si vazhdim, për vitin 2019 janë ndarë 70,000.00 €, kurse në aspektin e përgjithshëm deri në vitin 2021 janë

ndarë deri në 175,000.00 €, edhe për këtë fshat desha ta di se cila rrugë do të shtrohet, pasi që e di edhe për këtë fshat se cilat kanë qenë premtimet e kryetarit. Projekti i ri i cili është pas kodit 40809, ndërtimi i semaforëve të riinjë, këtë e kuptoj unë në dy aspekte, ndërtimin e semaforëve të riinjë a ka të bëjë me nderimin e semaforëve ekzistues, dhe nëse është kjo për muza është shumë gabim sepse semaforët janë në rregull, vetëm duhet të bëhet një projekt tjetër për nderimin e fazave dhe cikleve, e them këtë pasi që jam marrë me këto punë. Por nëse ka të bëjë me vendosjen e semaforëve të riinjë nëpër udhëkryqe tjera atëherë edhe kjo është gabim, për arsye se në vitin 2017 i kam bërë analizat e secilit udhëkryq në komunën tonë dhe niveli i shërbimit është i kënaqur, ku humbje kohore nuk kemi, maksimumi i nivelit të shërbimit ka qenë në nivelin B. Këto 20,000.00 € që janë ndarë për ndërtimin e semaforëve të riinjë mendoj se duhet të shpërndahen nëpër projekte të tjera të cilat do ju cekë shefi i grupit të LDK-së. Pastaj kemi projektin Krijimi i parkingjeve të reja në qytet, ku janë ndarë gjithsej 180,000.00 €, nuk jam duke e parë të arsyeshëm këtë shumë pasi që komuna e Rahovecit nuk e ka problem kyç parkingjet, ne me parkingje kemi problem vetëm në sezone, propozoj që shuma prej 80,000.00 € duhet të bartet tek projektet e tjera të cilat po ashtu do i cekë shefi i grupit, kurse shuma prej 100,000.00 € mendoj se mjafton për 3 vite për parkingje. Kodi 43488-Rregullimi i shtratit të lumit rimnik – vazhdim, a do të vazhdohet të mirëmbahet ky lumë sikurse që është mirëmbajtur deri më tani, pasi që rreth këtij lumi vetëm janë mbjellë disa pemë, kurse vërshimet nuk janë ndalur asnjëherë tek ura që lidhet me fshatin Drenoc, apo keni ndonjë plan që do të bëni diçka më ndryshe.

Florije Boshnjaku – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, në lidhje me qarkoren buxhetore 2019-2021, kemi diskutuar edhe në Prevallë kur kemi qenë, po ashtu edhe në KPF. Sa i përket investimeve kapitale e di që është një buxhet shumë i vogël, por e falënderoj kryetarin e komunës së bashku me stafin të cilët kanë bërë përpjekje sadopak që të mbulojë kërkesat e qytetarëve. Gjatë dëgjimeve buxhetore që i kemi pasur ne si grupe jo formal i grave, kërkesë nr.1 ka qenë ndërtimi i çerdheve, të nderuar kur i kam parë që janë hapur këto tri kode për ndërtim të çerdheve, me të vërtetë jam gëzuar shumë, sepse kjo është interes që do i mbulojë shumë kërkesat e grave, sepse e vetmja çështje që ju ndihmon grave është ndërtimi i çerdheve. Shpresoj dhe besoj tek kryetari, por edhe në emër të gjitha grave të komunës së Rahovecit, pasi që të miratohet ky buxhet të hapen këto kode, po ashtu të ju drejtohet MASHT-it edhe MAPL-së me kërkesë që të na ndihmojmë në këto kode, në mënyrë që të ndërtohen këto çerdhe sa më shpejtë, po ashtu shpresoj që çerdhja në qytet në këtë vite ose në fillim të vitit të ardhshëm të përfundojë. Shqetësimi tjetër i qytetarëve është edhe pse nuk është kompetencë e komunës, kur e thatë që është ngritur buxheti e kemi diskutuar edhe me z. Cena dhe kolegët e tjerët, është cekur se Qeveria e Republikës së Kosovës, ka vendosur që kur të dalin në pension mësimdhënësit të ju paguhen 3 paga shtesë, kurse të tjerët që marrin paga nga buxheti i Kosovës këtë të drejtë nuk e kanë të që të realizojnë, shpresoj se për vitet e tjera duhet që të mendojë Qeveria e Kosovës që të gjitha ata që marrin paga nga buxheti i Kosovës në momentin që dalin në pension të ju paguhen këto tri paga shtesë. Po ashtu e mbështes z. Rasim Fazliu i cili kërkojë një sqarim sa i përket kodit-Përkrhja e OJQ-ve për zhvillim rural, do e japë unë një sqarim, por për më shumë mundet edhe drejtori të më plotësoj. Më duket se kur ka qenë në kryetar komune Qazim Qeska në vitin 2009 është formuar një organizatë publiko – private, komuna dhe bizneset private aplikojnë në Ministrinë e Bujqësisë me projekte të ndryshme, mendoj se ky është projekti dhe ky projekt mendoj se nuk mundet të kalojë tek mallrat dhe shërbimet, sepse gjithmonë kjo ka shkuar përmes investimeve kapitale sepse edhe është investim kapital.

Mirjeta Krasniqi – Ne e kemi elaboruar këtë material të KAB-it bashkë me grupin, ku shefi i grupit në fund do i jepe kërkesat tona. Ajo që desha të diskutoj unë është, se të gjitha këto projekte që i keni paraparë janë të mirëseardhura për komunën tonë, por ne si anëtar të kuvendit duhet që të japim kontributin tonë dhe të i shtrojmë se cilat janë prioritetet. Mendoj që së pari duhet që të sigurohet uji, kanalizimet, rrugët, shkollat, trotualet, pra infrastruktura në përgjithësi, këto kërkesa duhet së pari të merren parasysh jo vetëm nga ju, por është dashur të merren parasysh qysh nga fillimi nga të gjitha qeveritë komunale, pra në ato vende ku ka nevojë më së shumti le të investohet, pa mare parasysh numrin e banorëve, nuk duhet të lihet anash asnjë vendbanim sepse të gjithë janë pjesë e komunës sonë. Të nderuar ka nxënës që shkon në shkollë

dhe vetura e përplasë atë, ka familje të cilat nuk kanë ujë të pijes, ka vende ku kanalizimi ka mbetur në gjysmë, ka shkolla që janë shumë të dëmtuara, dhe propozimi imë është që këto shkolla të rinovohen. Do të diskutoj tani pak rreth KAB-it 2019-2021, të nderuar e kam shfletuar mirë këtë buxhet por nuk pashë asgjë konkrete për fshatin Pastasel, p.sh tek kodi 43471- Ndërtimi i rrugëve në fshatrat Xërë, Celin, Nashpallë, që janë të mirëseardhura, kisha pas dëshirë të futet edhe emri i fshatit Pastasel. Po ashtu edhe në kodin e përmirësimit të kanalizimit është dashur të futet emri i fshatit Pastasel, kolegu z. Vahid Krasniqi i dha disa detaje ku ju mundeni të bënë manovrimet me buxhetin e viti 2019, prandaj edhe unë propozoj që ato shuma të vendosen në ato vende ku kanë prioritet më të lartë. Kodi 46727- Investime dhe mirëmbajtja e hapësirave publike, varrezave- vazhdim, ku keni shpërndarë shumën e mjeteve, kisha kërkuar që një shumë të hiqet nga ky kod dhe këtë punë ta kryejnë punëtorët sezonal, të cilët tani janë duke e kryer punën e ngjashme.

Ali Morina – Shpresojmë se këtyre projekteve si për kanalizime dhe rrugë, në përgjithësi infrastrukturë të i japim përgjigje sa më parë dhe buxhetin e komunës së Rahovecit sado i vogël që është ta orientojmë në investime zhvillimore. Sa i përket kornizës buxhetore ne e kemi diskutuar edhe kur na është paraqitur edhe në mbledhjet e mëparshme, ne konsiderojmë se planifikimi i buxhetit për vitin 2019 është bërë në mënyrë sa më të mirë, po ashtu shpërndarja e buxhetit në kode buxhetore është bërë në mënyrë të mirë, ku janë marrë parasysh të gjitha prioritetet e paraqitura nga qytetarët, qoftë nga dëgjimet publike të qeverisjes komunale, qoftë nga KPF-ja, ku pastaj të gjitha këto janë inkorporuar në kuadër të këtij buxheti. Ajo që më ka rënë në sy mua është rritja e shumës për subvencione në drejtorin për bujqësi, kulturë dhe zyra e kryetarit. Kjo është një formë e mbështetjes direkt si për fermerin, sportistin apo për secilën kategori që aplikon që të i gëzoj këto subvencione, prandaj shpresojmë se buxheti për kategori në vazhdimësi të ritet edhe në vitet e ardhme. Nuk do të lëshohem të diskutoj për secilin kod, sepse kolegët e mijë i ceken disa prej tyre, por konsideroj se është një buxhet i përfshirë mirë për të gjitha projektet kapitale të komunës së Rahovecit.

Munib Durguti – Desha vetëm disa sqarime për disa kode të cilat i kam të paqarta, po unë do të përqendrohem pak më shumë në Drejtorin e Shëndetësisë. Kam një pyetje për e planifikimit urban dhe mjedise, projekti- kolektori dhe rregullimi i shtratit të lumit Dullo – vazhdim, pyetje ime është se ku do të ndërtohet ky kolektor dhe mjetet e ndara nga vlera prej 40,000.00 €, a do ta përmbyllin në tërësi këtë projekt apo jo. e them këtë sepse jam nga banorët ku lumi Dullo e përshkon afër pronës sime, ky lumë ka nevojë për një mirëmbajtje, njëra anë e kanalizimit është pothuajse komplet e bllokuar sidomos anë nga parku i qytetit, kur kemi të reshurat e shiut me një sasi të vogël, uji dele nga shtrati i këtij lumi, më konkretisht më intereson ta di se çka do të punohet në këtë projekt. Sa i përket ndriçimit publik, meqenëse kodi është i përgjithshëm dhe ceket se ndriçimi publik do të bëhet në qytet dhe fshatra, ajo që më intereson mua është rruga e cila e lidhë rrugën Gëzim Hamza – Piktori dhe rrugën Ibrahim Rugova, meqenëse kjo rrugë kalon skaj gjimnazit Xhelal Hajda – Toni, sa për njoftim dua të ju lajmëroj se aty nxënësit mbledhen mbas dite në orët e vona dhe kjo zonë është shumë e errët dhe nuk ka ndriçim fare, kurse segmenti është shumë i shkurtër dhe nuk e besoj se do ti kushtoj shumë këtij projekti kjo rrugë. Prandaj propozoj që kjo rrugë të futet në agjendë dhe të bëhet ndriçimi i dyanshëm, njëra anë për rrugë, kurse ana tjetër për oborrin e shkollës. Sa i përket projekteve për shëndetësi, e përsëritës gatishmërinë për ta digjitalizimi i rëntgenin, ko është shumë e nevojshme, po ashtu në këtë drejtori janë edhe disa projekte në vazhdim. Po ashtu është shumë e nevojshme të ndërtohet QMF-ja në Çifllak, ju njoftoj që disa herë kemi bërë në atë kohë kërkesa që të përfitojmë nga grandet që i ndanë Ministria e Shëndetësisë për komunat, por kjo kërkesë nuk ka hasur në mirëkuptim, prandaj nuk kemi arritur që këtë projekt ta fusim në prioritet për ndërtimin në buxhetet ekzistuese, konsideroj se vlera është e vogël, por unë do japë propozim konkret. Projekti i ri- Vitalizimi i infrastrukturës për funksionalizimin e projektit shtretërit shtëpiake, kërkoj një sqarim nga drejtori se çka do të punohet dhe çka përmban ky projekt, përndryshe prej kësaj vlere që është 80,000.00 €, propozoj që të hapet edhe një projekt i ri e ai është: Zëvendësimi i ashensorit ekzistues në objektin e QKMF-së, ku për këtë projekt të i ndehen 20,000.00 €. Në të kaluarën kemi pasur shumë probleme, të gjithë e dini se në katin e fundit të QKMF-së është i vendosur sektori i maternitetit, ka pasur raste ku pacientët kanë mbetur në ashensor, për arsye të ndalje së rrymës

elektrike. Ne jemi në dijeni që është blerë një gjenerator për qendrën e dializës, do të ishte shumë mirë nëse ky ashensor do të kishte qasje në këtë gjenerator, ose të nderohet në tërësi ky ashensor, pasi është shumë i vjetruar dhe kohë pas kohe i nënshtrohet riparimit. Pastaj kodi i ri është – Ndërtimi i shtëpive me material ndërtimor për familje në nevojë, konsideroj se projekti është shumë i qëlluar dhe komuna duhet që të ketë në vazhdimësi projekte të tilla me vlera modeste, sepse nevojat janë të mëdha, kërkesat janë në pritje dhe e dimë saktë se shtëpia e banimit social nuk do i përmbushë të gjitha kërkesat e qytetarëve. Problemi është se ky projekt po fillon nga grandit specifik për shëndetësi, ne e dimë që sipas ligjit për financa publike, ky grand është i mbrojtur me ligj dhe duhet që të shpenzohet vetëm për çështje shëndetësore dhe jo atë për mirëqenie sociale, neve na huton fakti sepse shpesh herë kur e lexojmë na dele Drejtoria për shëndetësi dhe mirëqenie sociale, por kemi raste në Kosovës që kjo mirëqenia sociale i bashkëngjitet një drejtorie tjetër. Propozimi imë është që ky projekt të mbyllet dhe mjetet prej 35,000.00 € të barten për ndërtimin e QMF-së në Çifllak, kurse projekti që do të mbyllet të hapet në një drejtori tjetër, apo në Qendrën për Punë Sociale, në kuadër të projekteve me bashkëfinancim. Vërejtjet tjera nuk kam, uroj që këto propozime të merren parasysh dhe të ecim tutje.

Fehmi Cena – Ne sot jemi duke e shqyrtuar një pikë të rëndësishme e cila ka të bëjë e buxhetin për vitin 2019, dhe për KAB-in 2019-2021, dhe sigurisht se diskutimet do të jenë më të gjata dhe besoj se do të mirëkuptohemi për këtë. Për mua KAB-i është një dokument i cili ka shumë rëndësi sepse është garanci për zhvillimin e komunës, dhe e gjithë kjo e ngritë mirëqenien e qytetarëve. Tek pjesa e strategjisë zhvillimore komunale, do të ndalem pak tek shëndetësia, ne kemi pasur edhe më herët vërejtje rreth kësaj, ku disa janë mare parasysh disa nuk janë mare, pastaj disa janë të përgjithshme dhe disa janë konkrete. Janë të cekura 12 synime për shëndetësi, njëra nga ta është Ndërtimi i QMF-ve, ne edhe më parë kemi pasur vërejtje rreth kësaj, ku kemi kërkuar që si në shëndetësi ashtu edhe në arsim buxheti të mos orientohet shumë në ndërtime të objekteve, por më tepër të orientohet në mirëmbajtje dhe në renovime të objekteve ekzistuese, dhe në përmirësim të kushteve të punës. Pastaj nuk jam duke parë në shëndetësi diçka të ceket rreth mjekësisë familjare, komuna jonë nuk e ka të zbatuar pjesën më të madhe të konceptit të mjekësisë familjare, mendoj se kjo duhet që të jetë qendra e strategjisë, sepse mjekësia familjare është gurë themel dhe vazhdimësi e shërbimeve ku ne duhet të angazhohemi nëse mendojmë ta zhvillojmë shëndetësinë. Hapi i parë do të ishte sigurisht që të kemi një vëmendje më të madhe për mjekë familjarë, pra specializimi i mjekësve familjar, këtu nuk e pashë të cekur askund, ne nuk mundemi të themi në periudhën tre vjeçare se një ditë do të krenohemi me shërbime shëndetësore nëse nuk punojmë shumë në këtë drejtim, besoni jemi shumë mbrapa. Tek buxheti në shëndetësi të hyrat vetanake është bërë planifikimi prej 50,000.00 €, për këtë kemi pasur vërejtje edhe më herët, kjo shumë për shëndetësinë e komunës së Rahovecit nuk mundet të realizohet nga participimi nëse nuk zbatohet sistemi i informimit shëndetësor elektronik, për arsye se janë të hyrat nga dy burimet nga vetë pacientët dhe nga banka botërore e cila paguan për secilin pacientë, po ashtu edhe si të hyrë është Certifikatat për patentë shofer. Në faqe nr.12 konkretisht tek kategoria e pagave dhe mëditjeve, znj. Florije diçka ceki rreth 3 pagave që po jepen të pensionuarve nga arsimi, pra këtu ceket vetëm për punëtorët e arsimit, ne në të kaluarën kemi pasur vërejtje që kjo nuk duhet të jetë vetëm për punëtorët e arsimit, por duhet të jetë edhe për punëtorët shëndetësor dhe punëtorët e administratës. Me sa duket ne në edhe vitin 2019 do të kemi probleme me punëtorët e shëndetësisë sa i përket pagesës së 3 pagave pas pensionimit, pastaj këtu ceket se pagesa e 3 pagave pas pensionimit për punëtorët e shëndetësisë është bërë konform marrëveshjes që është bërë me mes sindikatës në kontratën kolektive, sa jam në dijeni unë kontrata kolektive ekziston dhe është nënshkruar në mes Ministrisë së shëndetësisë dhe sindikatës së shëndetësisë. Por nëse kjo është në kompetencat e komunës, atëherë komuna duhet të merr përsipër, pra nuk duhet të bëjë ndarje të punëtorëve, nëse ka rritje të buxhetit kjo duhet të ndahet në mënyrë të barabartë për të gjithë. Kjo ishte sa i përket strategjisë, tani do të dalë tek projektet konkrete, tek Drejtoria e Shërbimeve Publike kodi 43467- Ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës Drenoc – Zatriq, të nderuar ne kemi menduar se kjo rrugë është kryer në mandatin e kaluar, është përfolur mjaftë që ka kushtuar shtrenjtë dhe nuk është ndonjë rrugë e ndonjë

rëndësia të madhe sepse popullata atje është e vogël, megjithatë është mirë që është kryer, ky projekt ka kushtuar diku mbi 400,000.00 €, kurse tani prapë janë duke u paraparë mjete për këtë projekt për 3 vite 125,000.00 €. Dua një sqarim për këtë a është e domosdoshme me u parapa mjete për këtë projekt, nëse jo atëherë kisha propozuar që këto mjete të destinohen në ndonjë projekt tjetër. Z. Vahid Krasniqi më herët e ceku kodin 43471- ku në këtë kod nuk specifikohet se cilat rrugë do të rregullohen si në Drenoc dhe fshatrat e tjerë që i përmendi, mirë është që të dihet se cilat rrugë do të rregullohen. Po ashku fshati Pastasel nuk ceket askund, si për ujë të pijes, për kubëzim të rrugicave, trotuareve etj. Ky fshat nuk ka asnjë rrugë dhe asnjë trotuar me kubëza, prandaj ne kërkojmë që të jeni më konkret, po ashtu kërkojmë që të përfshihet në ndonjë projekt edhe fshati Pastasel, sepse ky fshat ka nevojë për investime. Pastaj për semaforët e rinjë janë ndarë 20,000.00 €, e ceku edhe z. Vahid Krasniqi, dhe nëse me të vërtet nuk është e domosdoshme atëherë këto mjete mirë kishte me qenë me i bartë me një projekt tjetër të rëndësishëm, si në subvencione në bujqësi ku e dimë se komuna jonë ka shumë nevojë. Kodi 46727- Investimet dhe Mirëmbajtja e Hapësirave Publike – Varrezave, mendoj se shuma të cilën e keni ndarë për 3 vite për këtë kodë është goxha shumë, mendoj se këtu bëhet pak punë kurse shpenzohen shumë mjete, ne të gjithë e kemi parë se si janë duke u mirëmbajtur hapësirat publike dhe askush nuk jemi të kënaqur, mendoj se këtu duhet që të gjendet metoda e kursimeve, nëse ka mundësi që të punësohen njerëz me punësime sezonale do të ishte edhe më mirë dhe me siguri dhe mirëmbajtja do të ishte më e mirë dhe po ashtu do të kishim punësuar njerëz që janë pa punë. Kodi 43489 përmendet në një kod lumi Dullo, po ashtu përmendet edhe kolektori, shumë që është ndarë për këtë kod është shumë e vogël, 40,000.00 € për vitin 2019, pastaj për vitin 2020 90,000.00 €, kurse kolektori është shumë më i kushtueshëm, nuk e di qysh keni menduar që të bëni kolektorin me këtë shumë kaq të vogël të hollave. Kodi 40848 – Kompleksi i Dëshmorëve të Gradishit, ku janë ndarë 40,000.00 € për 3 vite, kur jemi tek kompleksi i dëshmorëve në Gradish, ne duhet që të ri ‘definojmë pozitën, qëllimin dhe kujt i shërben ky objekt, ky objekt edhe ashtu ka kushtuar shumë, pra para se të definohet statusi i këtij objekti së paku për vitin 2019 shuma prej 20,000.00 € të i hiqet këtij objekti. Tek shëndetësia projekti – Dezinfektimi, dezinfektimi dhe deratizimi shuma e projektit 30,000.00 €, mendoj se kjo shumë është tepër e lartë, ne më parë këtë punë e kemi kryer edhe me 3,000.00 €, dhe nuk mendoj se kjo punë po i shërben vërtet qëllimit, nuk ka nevojë komuna të shpenzoj gjithë këto mjete për këtë projekt, prandaj mendoj se më shumë se 10,000.00 € nuk është nevoja të ndahen, sepse edhe ashtu nuk kemi ndonjë sukses me këtë punë, është bërë një përshtypje se dikush po e merë tenderin, po merë të holla, po dele po stërpik diçka, por në fund nuk e dimë se çka është duke u bërë sepse deri më tani askush nuk ka hulumtuar dhe të na tregoj se kjo punë kaq ka qenë e suksesshme. E kam përmendur Qendrën e Shëndetit Mendor Bazuar në Bashkësi, është një kategori e të sëmurëve psikikë që i ka komuna jonë, prandaj komuna ka mundësi që ta ndërtoj një objekt me një shërbim jo shumë të madh shëndetësor, dhe këta të sëmurë psikikë nga komuna jonë me u mjeku aty, ata atyre kryejnë qëndrimin ditor dhe marrin barëra të veçanta, kjo është një kategori që me të vërtet kanë nevojë për një trajtim që ne kishim mundur të ja ofrojmë përmes Qendrës së shëndetit mendor. Pastaj është një projekt i ri këtu i cekur vitalizimi i Infrastrukturës për funksionalizimin e Projektit Shtretërit Shtëpiak, shuma e ndarë është 80,000.00 €, kisha kërkuar nga drejtori një sqarim, nëse kjo është shërbimi shtëpiak ku një ekip mobile shkon dhe i mjekon pacientët e pafuqishëm (të palëvizshëm), fizikisht, mendoj se shuma prej 80,000.00 € është një shumë goxha e madhe, mendoj se duhet të jetë një projekt goxha i mirë dhe i detajuar në aspektin profesional në mënyrë që të na mbushet mendja. Tek kodi 45349 – Riparimi i Monumenteve Historike, jam ithtari i asaj që monumentet e rëndësishme historike dhe trashëgimisë të mirëmbahen, mendoj se shuma prej 55,000.00 € e ndarë për tre vite është pak, mendoj se duhet më tepër të investohet ngase kemi objekte të trashëgimisë që janë në shkatërrim e sipër dhe nëse ne nuk përkujdesemi brenda këtyre 3 viteve, atëherë këto objekte do të shkatërrohen dhe ne pastaj kot e kemi edhe nëse investojmë. Projekti i ri Ndërtimi i Kompleksit Sportiv në Zonën Turistike në Rahovec, ku për tre vite janë ndarë 30,000.00 €, ne këtë projekt vetëm si emër e kemi parë, askush nuk na ka prezantuar, por mendoj se shumë pak mjete janë ndarë për këtë projekt. Sa i përket arsimit e kam cekur edhe më herët se duhet të

investohet më shumë tek nxehjet qendrore nëpër shkolla, në mënyrë që kushtet të jenë sa më të mira. Po ashtu i bashkëngjitem mendimit të z. Rasim Fazliu i cili e tha se disa prej kodeve që neve na duken se nuk i takojnë investimeve kapitale të barten në pozicionin për shërbime dhe mallra dhe pozicionet e tjera përkatëse. Besoj se e regjistruar propozimet tona, kërkojmë përgjigje nga ana e juaj para se të vendosim për të votuar.

Fahrije Lushi Morina – Përshëndetje për të gjithë të pranishëm, meqenëse parafolësit e mijë, po ashtu edhe shefi i grupit, ku i dhëna të gjitha ato sugjerime dhe kritika të cilat i përplotësojnë çdo vërejtje ose çdo mangësi brenda kësaj kornize afatmesme buxhetore e cila parasheh një periudhë më të gjatë, dhe ne i kemi parasysh se cilat janë ato që ma tepër na shqetësojnë. Do të ndalesha tek dy kode, kodi 89742 – Projekti Kullimi i Tojave Bujqësore Ratkoc, Malësi e Vogël dhe Gexhë – vazhdim, kjo është një gjë e mirë, por tek projekti i kubëzimit të rrugëve keni përmendur që janë të një vije rrugore, si Dobidoli, Polluzhë, Ratkoc, Gexhë, Kramovik dhe Guri i Kuq, kurse fshatin Malësi e Vogël e keni anashkaluar, apo thjeshtë e keni lënë të nënkuptohet që i lidhë e njëjta vijë rrugore, në këto fshatra që i përmenda e dini mirë që mungojnë dhe kushtet më elementare siç janë: Ndriçimi, kanalizimi etj. kjo vijë rrugore është mjaftë e frekuentuar duke filluar nga fshati Gexhë e deri në Ratkoc, këtu kalojnë nxënës dhe qytetar të ndryshëm të cilët shkojnë për të kryer obligimet e tyre në Ratkoc dhe anasjelltas.

Trajko Shariq - I nderuari kryesues kam një vërejtje sepse nuk më ka ardhur mua lista e projekteve kapitale me kohë nuk i di arsyen pse, po ashtu nuk është mare parasysh ndonjë propozim sa i përket komuniteteve, unë si përfaqësues i këtyre komuniteteve nuk më është dhënë mundësia që ti prezantoj projektet të cilat janë në të mirë të komunitetit. Këtë po e them për arsye se banorët e fshatit Hoçë e Madhe qysh nga viti 1999 nuk kanë ujë të pijshëm, janë duke i shfrytëzuar burimet lokale ose burimet alternative të cilët rrezikojnë shëndetin e tyre, për arsye se nuk i plotësojnë kushtet e përdorimit. E kam para vete kopjen e projektit i cili e zgjidhë problemin e ujit të pijes në këtë fshat, sipas vlerësimit ky projekt kushton 305,000.00 €, sipas informatave të cilat i kamë kompania e Radoniqit është gatshme që 50% të këtij projekti të i investoj ajo, kurse 50 % komunitetit. Këtë po e them për arsye se është një projekt me prioritet dhe duhet të merret parasysh për planifikim të buxhetit 2019-2021 si investim kapital. Po ashtu këtu i kam vërejtur dy tabele që janë të ndryshme por në thelb flasin për të njëjtën gjë, kodi 43481 – për investime kapitale në realizimin e projekteve për zyrën e komuniteteve janë të paraparë 30,000.00 € për vitin 2019, kurse në fletën tjetër thuhet se janë të ndarë 51,685.00 €, pra nuk janë të përfshirë shifrat e njëjta, do të doja sqarim shtesë rreth kësaj.

Dervish Çadraku – Të nderuar nëse e marrim këtë dokument i cili është shumë i rëndësishëm për qytetarët e komunës së Rahovecit, i cili në një farë mënyre është një pasqyrë në të cilën do të veprojnë qeveritë e ardhme ose e tashme, në mënyrë që qytetarët e komunës sonë ta kenë një jetë sa më të mirë. Nëse i shfletojmë fletat e parë të këtij buxheti, me të vërtet janë shumë pozitive objektivat e juaja, mendoj se shumëçka është përfshirë në këtë buxhet, por ka edhe gjëra të cilat qytetarët e komunës sonë kanë shumë nevojë por nuk janë të përfshirë në buxhetin viteve të ardhshme, por është mirë që të ju përkujtojmë ne sepse kjo është në të mirën e qytetarëve dhe qeverisë suaj. Në faqe nr.8 është një tabelë e cila tregon se nuk keni qenë shumë të përkushtuar në objektivat e juaja, tek tabela nr.1 e keni indikatorët ekonomik komunal, popullsia e komunës së Rahovecit 56208 mijë banorë, këtë nuk e dini as ju dhe as ne sa i ka dhe sa do ti ketë deri në vitin 2021. Pastaj ajo që ma tërhoqi vëmendjen ishte numri i bizneseve të regjistruar, ku keni cekur se në vitin 2021 do të ketë 3990 biznese, kurse sot janë 3215 biznese, nëse e kalkulojmë këtë na dele që rreth 775 biznese ma shumë deri në vitin 2021. Indikator që mundemi me kontrollua se sa do të jenë është edhe numri i nxënësve, ku ceket se këtë vit janë 12871 nxënës, kurse në vitin 2021 parashihet që të jenë 10820, që i bie 2051 nxënës më pak, ajo që dua të them është se edhe projekte, por edhe planet tona që i bëjmë ne për qytetarët e komunës sonë duhet të jenë reale. Sepse nuk ka mundësi që të bie numri i popullsisë kurse të rritet numri i bizneseve. Ju e dëgjuat se çka tha Ministri i Shëndetësisë në muajin shkurtë do të shkojnë 99 mjekë nga Kosova, prandaj është një alarme që duhet të kemi parasysh dhe të shikojmë

mundësitë se si të i ndalim këtë njerëz që mos të ikin nga Kosova, ne këta njerëz nuk mundemi të i ndalin që mos të shkojnë duke i mbyllur disa gripa të rrugëve. Prandaj kishte me qenë mirë që të orientohen parat aty ku bëhet rigjenerimi i vendeve të punës dhe këta njerëz të punësohen këtu e jo të ikin jashtë Kosove, sepse nëse vazhdohet kështu, do të shkojnë të gjitha profesionet por edhe ata pa profesione, dhe ne do të mbesim qeveri pa qytetar. Tek drejtoria e Shërbimeve Publike nëse i kalkulojmë të dy shtyllat, për vitin 2019 do të kemi diku rreth 1,587,076.00 € investime në këtë drejtori, këtu i kemi disa projekte që nuk janë të specifikuar me emra dhe mbiemra, në të dy takime kemi kërkuar që këto të jenë të specifikuar, dhe kjo ndoshta do të më shtyjë që mos ta votoj këtë buxhet. Kemi mungesë të trotuareve, mungesë të shtrimit rrugëve, mungesë të rregullimit të parqeve, shesheve etj. Ne e dimë se me këto mjete që i kemi në dispozicion nuk mundemi të gjitha të i rrumbullakojmë, por ne mundemi të i qesim që edhe qytetarët të bashkëpunojnë me ne, ju si ekzekutiv rregullimin dhe mirëmbajtjen e parqeve e sidomos të rreth rrotullimeve hiç nuk keni mundur ta bëni, i keni lënë në mëshirë të natyrës, e kam një propozim për këtë, është mirë që ti jepen bizneseve që ti përdorin duke i lëna që ata të vendosin tabelat e tyre të reklamimit duke mos i kërkuar komuna taks për ato, kjo pastaj edhe neve do na ndihmojë, po ashtu do të krijohet një pasqyrë e mirë për qytetarë. Sa i përket parkingjeve ne kotë jemi duke folur sepse parkingje nuk kemi dhe nuk mundemi me bërë asgjë rreth kësaj, por ja që unë e kam një propozim, prandaj e thash unë se dalloj nga parafolësit e mijë sepse jam i drejtpërdrejt. Rruga nga semaforët ka stacioni i autobusëve i ka trotualet e gjerë, por qytetarët prapë se prapë në rrugë ecin, po ashtu ato topat ose sferat diku rreth 60-70 centimetra vetëm një sferë e zë trotualet por nëse i llogarisim dy sanë të rrugës do na del diku një metër e gjysmë, pse nuk i heqim ne këto topa dhe i bëjmë disa parkingje të cilat do i shërbejnë edhe bizneseve, por edhe qytetarëve për parking të automjeteve. Pastaj tek drejtoria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimi Rural, këtu gjëja më e rëndësishme është që të identifikohen problemet, e ato probleme janë ato të cilat i kishim para disa dite: si vërshimet që kanë ndodhur në komunën tonë, ku ekonomitë tona familjare dhe bujqësore kanë pësuar dëme, pastaj i kemi disa procka të cilat nuk kanë krye, paradoksi i gjithë kësaj është se ne në vend se të ja fillojmë që ti ndërtojmë këto procka nga fundi ne ja fillojmë nga kreu, pastaj krijohen disa hinka ku të gjitha derdhen në këto procka. Kjo e gjitha bëhet nga neglizhenca e komunës e cila nuk bisedon me qytetarët e komunës që të lëshojnë token sa për të u zgjeruar procka, sepse e gjitha është në të mirën e qytetarëve. Pastaj kemi ndotje të ambientit dhe të ujërave nga ujërat e zeza, ne nuk jemi duke i trajtuar ujërat e zeza, paramendoni komuna e Rahovecit nuk ka impiant ose gropa septike, pastaj bodrumet e pijeve të cilat gjenden në Komunën e Rahovecit e bëjnë ndotjen po aq të madhe sa ujërat e zeza, ne nuk e dimë se këta podrume a e bëjnë filtrimin e atyre ujërave që janë aq të dëmshme dhe të rrezikshme, të gjitha këto derdhen në lumin Drini i Bardhë, inspektorati nuk mundem me na dhënë përgjigje a e kontrollon këtë gjendje të këtyre bizneseve, pra ndotja është duke u bërë në mënyra katastrofe e florës dhe faunës. Kur është fjala për bujqësi ne si komunë kemi mungesë të tregjeve, pastaj përpos tregjeve ne kemi mungesë edhe të grumbullimit, ne kemi mungesë të ruajtjes së frutave, kam biseduar me njërin nga ata që merren me pemë, ku thotë se këtë vit nuk janë duke na i marr pemët, kurse unë kam pas shpresë se këtë vite do i mare diku rreth 10,000.00 €, kurse unë nuk kam ku ti ruaj ato pemë dhe siç o duket ato do të kalben dhe ai do to hedhë sepse nuk ka ku ti ruaj. Prandaj i nderuari kryetar është mirë që ti stimuloni edhe këta e jo vetëm bujqit, sepse ene jemi duke ju bërë dy herë kancerin, e parë ne nuk jemi duke i mbrojtur nga natyra, e dyta ata prodhojnë hiper prodhim dhe atë ata duhet që të hedhin, prandaj mendoj se kishte me qenë mirë që qendrat e grumbullimit ti stimuloni në çmim, pra nëse njëri ka kaç kilogram produkte të frutave ju të i ndani në 1kg disa cent, pra si mbështetje nga ana e komunës, me këtë ne i ndihmojmë qytetarëve të komunës sonë. Ju e dini se ne ish Jugosllavi ka pasur treg deri në Lubjanë dhe në Beograd, në atë kohë njerëzit janë bërë shtëpi me bujqësi, kurse tani ne me bujqësi nuk po kemi mundësi as vitin tjetër ta presim, ne duhet që vitin tjetër të hymë në kredi, në mënyrë që të filloj me përgatitjet e sezonës në bujqësi. Shëndetësia dhe mirëqenia, kemi ndërtuar një traditë ne si qeverisje që kur të vijmë gjithmonë të krijojmë objekte, shkoila etj. por duhet të dini se këto nuk janë gjithmonë ose domosdoshmërisht të nevojshme, më s mëri kjo na tregon në shkolla,

shkolla e Malësisë së Vogël i ka pasur më parë rreth 700 nxënës, kurse sot i ka mbi 400 nxënës. Të nderuar shkollat kanë nevojë përpos objekteve të reja aty ku ka nevojë, kanë nevojë edhe të riparohen, pastaj kanë nevojë që të furnizohen me teknologji informative, me kabinete të fizikës, kimisë dhe biologjisë, pra për këto kanë nevojë nxënësit, pastaj kanë nevojë nxënësit për rekuizitat sportive sepse në disa shkolla as top për të luajtur nuk kanë, pastaj duhet që të stimulohen që kenë aktivitete të lira gara sportive, grupe të poeteve etj. këto janë ato që një nxënës ja bënë shkollën të dëshirueshme dhe të ndjej kënaqësi se pse nuk zgjati dita më shumë, kurse në këto aktivitete nuk i kemi nëpër shkolla, pra nëse dëshironi që të keni tamam një shkollë dhe mësim cilësor atëherë duhet që të këto të i bëni. Kurse sa i përket shëndetësisë, kam qenë dy ose tre herë në QKMF në Rahovec, aty nuk ka as barëra më të thjeshta, nuk ka reagens, nuk ka as aparate më të thjeshta për analiza. I nderuari kryetar këtu është esenca, pra qytetari duhet që ti ketë shërbimet e domosdoshme në QKMF, ju do ta ndërtoni edhe një ambulant në Çifllak, kurse në Polluzhe është AMF-ja jo funksionale, po ashtu edhe në Malësi të Vogël e ke pothuajse jo funksionale, pastaj kemi mungesë të mjekëve, prandaj është mirë që të mendohet edhe në këtë drejtim. Kur jemi tek kultura, mendoj se trashëgimia kulturore nuk është duke u mirëmbajtur, monumentet nuk janë duke u mirëmbajtur mjaftueshëm, obelisku në fshatin Gradish ka vite që është duke u zvarritur, kurse tani i keni ndarë 20,000.00 € dhe deri në vitin 2021 nuk ka mundësi që të rregullohet. Qëllimi i këtij objekti ka qenë që të reflektoj betejën e Gradishit të luftës çlirimtare të Kosovës, pastaj por ashtu ky është në muze e cili rigjeneron vende të reja të punës, pastaj në atë pjesë është edhe një amfiteatër ku lojërat e ndryshme dhe koncertet mendoj se munden aty të mbahen, pastaj kjo mundet të ndërlihet edhe me urën e Gradishit, kjo urë është monument historik që nuk e kanë të tjerët, pse mos të investohet tek kjo urë dhe të krijohet një plazh i mirë për qytetarët e Komunës sonë dhe aty do të rigjenerohen vendet e reja të punës. Pastaj tek Maja e Zatriqit pse nuk bëjmë një kamp rekreacioni, sepse atje bora bie e par dhe e fundit hiqet, pra atje mundet të ndërtohen sipërfaqe për skjim dhe ndërtesa kampingu dhe këto prapë gjenerojnë vende të reja të punës. Pastaj e kemi Sahat Kullën, e cila është emblemë e komunës së Rahovecit dhe posaçërisht komunës së Rahovecit, kurse ne aty nuk kemi investuar asgjë, është diskutua më parë që do të shpronësohen disa parcele përreth, mendoj se është gjynah që të mbetet ky monument historik në këtë gjendje, e pash se rreth 30,000.00 € do të ndahen për Festivalin e Rrushit - Hardh Festë, kjo festë zgjat diku 3 ditë, ndërsa nuk ndajmë diçka për të cilën komuna e Rahovecit identifikohet, mendoj se është mirë që të mendohet edhe për këtë drejtim. Të gjitha këto që i diskutova deri më tani mendoj se është për të mirën e juaj, sepse nëse ju keni qeverisjen e mirë do të reflektoni mirë, prandaj jam këshilltar e jote ju dëgjoj çka të më thoni ju, unë ri çdo ditë me banorë të komunë sonë, kurse ju nuk rini për çdo ditë.

Vjosa Isma – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, do të isha ndalur tek kodi 40817 – Projekti Ndërtimi i rrugëve në komunën e Rahovecit, pyetje ime shkon për rrugën Bekim Sylka, ka gati 1 vit që janë duke punuar në këtë rrugë dhe ende nuk është përfunduar, pyetje e qytetarëve është se kur do të përfundoj kjo rrugë, sepse çdo ditë janë duke i prishur veturat e tyre kur kalojnë në këtë rrugë. Po ashtu kam një pyetje sa i përket Kroit tek Sheshi i Republikës, kur do të rregullohet, jam duke parë që në buxhet është paraparë një kod për rregullimin e objekteve të trashëgimisë kulturore, por nuk është e specifikuar se cilat objekte do të rregullohen. Kroi tek Sheshi i Republikës në Rahovec është njëri nga vlerat historike të qytetit duke pasur parasysh edhe lagjen si njëra ndër lagjet më të vjetra, po ashtu mendoj se ky aktivitet nuk kërkon shumë buxhet për tu rregulluar.

Besmire Bytyçi – Desha vetëm ta plotësoj shefin e grupit tim se në këtë projekt buxhet është edhe një projekt Stalla dhe ferma të vogla për fermerë i cili nuk duhet të jetë tek kodi i kapitalëve, mendoj se ky është subvencion. Po ashtu është edhe një kod i ri - Përkrahja për Biznese, mendoj se këto dy kode duhet bashkangjitur propozimit që e dha z. Rasim Fazliu.

Refki Kryeziu – Tek planifikimi i investimeve kapitale për vitin 2019-2021, i mbështes të gjitha propozimet, vërejtjet dhe sugjerime që i dhe shefi i grupit tim z. Rasim Fazliu. Unë do të ndalem pak tek DKA-ja, jam duke parë se këtu janë disa projekte në vazhdim dhe disa projekte të reja, i nderuari kryetar

edhe shkolla "Hamëz Thaqi" në Xërxë nuk është në gjendje të mirë, mundësisht të keni parasysh në një të ardhme të afërt që ta zgjidhni edhe këtë problem, arsyja pse po e them është sepse numri i nxënësve në fshatin Xërxë është në rritje për dallim nga fshatrat e tjerë, vitin e kaluar kanë qenë rreth 42 nxënës në klasë të parë, kurse këtë vit rreth 60 nxënës, për shkak të emigrimit nga fshatrat e tjerë në Xërxë, numri gjithmonë shkon duke i rritur.

Sali Sallteku – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, është duke u vërejtur mungesa e drejtorit të financave, sepse korniza buxhetore që na ka ardhur ka shumë të meta, u cekën të gjitha nga shefat e grupeve parlamentare, prandaj mendoj se kjo kornizë duhet që ti merë parasysh të gjitha sugjerimet që u dhanë deri më tani. Ka shumë për tu thënë rreth kësaj kornize, është cekur sigurimi i objekteve shëndetësore, mendoj se duhet që të sigurohen edhe objektet e tjera të komunës e jo vetëm objektet shëndetësore, prandaj mendoj se ka shumë çka për tu përmirësuar në këtë kornizë buxhetore.

Arben Sokoli – Po filloj që të ju japë përgjigje pyetjeve siç janë parashtruar me radhë, i nderuar z. Rasim Fazliu është e vërtetë se të hyrat vetanake në tërësi kanë zbritje, por nuk është gabim ajo që e kemi cekur se ka pasur rritje, kjo është kryesisht e koncentruar nga tatimi në pronë, arsyja është sepse kemi rritje nga të hyrat e tokave, planifikohet në vitin 2019 të tatimohen tokat dhe me këtë do të ketë një buxhet të planifikuar. Sa i përket zbritjes në çdo vit kemi pasur vërejtje nga auditori që të bëhet një planifikim për tatimin në pronë i cili nuk është realizuar asnjëherë, kështu që planifikimi i tatimit në pronë është zvogëluar për 30,000.00 €, kurse planifikimi i të hyrave nga tatimi në tokë është 78,767.00 €. Kurse sa i përket mallrave dhe shërbimeve që ka rritje, në të gjithë ato kode që kanë pasur vërejtje nga auditori në vitin 2017 i kemi larguar nga pozicioni i investimeve kapitale dhe janë bartur në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve, po ashtu janë rritur mallrat dhe shërbimet për 105,000.00 € me kërkesën e juaj në bazë të qarkores Nr.1. E nderuara znj. Florije Boshnjaku 3 paga pas pensionimit nuk i cakton komuna por këto i përcakton MF. Sa i parket asaj se nuk janë përfshirë rekomandimet e juaja, i nderuari z. Fehmi Cena, në KPF ka qenë vetëm një propozim nga znj. Florije Boshnjaku që të futet në Drejtorin e Shëndetësisë Ofrimi i shërbimit të shëndetësisë për të gjithë qytetarët e komunës së Rahovecit, kjo i nderuar është përfshirë në KAB. Pastaj propozimi tjetër ka qenë nga ju z. Fehmi Cena, që në kuadër të projektit për pleq të shtohet edhe ndërtimi i shtëpisë së pleqve për qëndrim ditor, ky projekt është futur në tabelën e investimeve kapitale. I nderuari z. Trajko në tabelë e keni të cekur sipas kategorive dhe programeve, aty janë të cekura 30,000.00 € që janë në kuadër të Zyrës për Komunitete deri në vitin 2021, ku në vitin 2019 janë ndarë 30,000.00 €, në vitin 2020 janë ndarë 30,000.00 €, kurse në vitin 2021 janë ndarë 50,000.00 €, pra në totalë është buxheti prej 110,000.00 €. Desha të shtoj diçka sa i përket projektit Përkrahja e bizneseve dhe fermerëve, pasi punoj në Drejtorin e Financave konsideroj se ky është një projekt kapital, ne kemi dhe projekte të tjera si ndërtimi serave i cili është me participim që është e njëjtë. Kurse sa i përket keq klasifikimeve për vitin 2017 nuk ka qenë shkak i pasqyrave financiare që kanë dalë të modifikuara për keq klasifikime, pasi që për vitin 2017 ka qenë buxheti i aprovuar pesë shifror, po ashtu rishikim të buxhetit nuk kemi pasur në vitin 2017, kjo ka qenë rezultat i pasqyrave financiare që ka dal nga raporti i auditorit të modifikuar, kështu që në tabelën e investimeve kapitale të gjitha projektet që janë të përfshira nuk janë subvencione dhe nuk janë mallra dhe shërbime, por të gjitha janë investime kapitale.

Rasim Fazliu – Falënderoj zyrtarin e financave për të gjitha sqarimet që i dha, por i them zyrtarit se unë e them atë që e lexoj, e jo atë që ai mendon në kokën e tij, këtu shkruan: të hyrat vetanake kanë shënuar zvogëlim ose rrënjë, por pak më poshtë prapë ceket se kjo rritje kryesisht është koncentruar në të hyrat nga tatimi në pronë, ku nga viti 2018 planifikohet tatimi edhe i tokave. Mendoj se kjo është një gabim sepse viti 2018 ka filluar përfunduar gati dhe asgjë ende nuk ka filluar, prandaj mendoj se unë kam të drejtë rreth kësaj e jo zyrtari i financave. Propozoj që kjo çështje të sqarohet e jo të dalim me këso gabime para qytetarëve. Pastaj për të gjitha këto projekte të reja që e ceka se i takojnë kategorisë së mallra dhe shërbimeve dhe kategorisë së subvencioneve, konkretisht ju pyes projekti Përkrahja e fermerëve në komunën e Rahovecit me mekanizëm bujqësor, inpute bujqësore, farëra, plehra kimik etj. Mendoj se këto nuk janë investime

kapitale mos lozni me ne, nëse nuk besoni atëherë ne mundemi të ftojmë një ekspertë të ekonomisë që të na sqaroj këtë, e pastaj do të shikojmë se kush ka të drejtë.

Përparim Krasniqi – Së pari dua ta falënderoj z. Rasim Fazliun, që në fillim e tha se buxheti komunal i Rahovecit duhet që të respektohet në dy mënyra: Një nga auditimi i jashtëm që është bërë dhe e dyta nga kërkesat e qytetarëve që kanë dalë nga dëgjimet buxhetore për planifikimin e ri të buxhetit për vitin 2019. Të nderuar shumica e projekteve kapitale janë vazhdimësi e projekteve të trashëguara, ne jemi duke i përfill rekomandimet e auditorit të jashtëm që kontratat që janë në vazhdim nuk duhet lënë anash, por duhet përfunduar në tërësi. Kam pas një pyetje sa i përket menaxhimit të mbeturinave të ngurta, por të nderuar në vitin 2019 kemi një marrëveshje me organizatën japoneze Xhajka, ku do të vinë pesë ekspertë nga kjo organizatë në komunën e Rahovecit, ku do të sigurohet një zyre, ku pastaj do të fillohet me planifikimin e ri të menaxhimit të mbeturinave, parashihet që të bëhet një data bazë ku ende në nivel të Kosovës nuk është bërë, u do të futen të gjitha shënimet nga tatimi në pronë dhe do të bëhet një planifikim i ri për inkasim të mbeturinave në komunën e Rahovecit. I nderuari z. Vahid Krasniqi projekti i ndërtimit të rrugëve në Drenoc është projekti në vazhdimësi i trashëguar nga viti 2017, ku planifikohet që në vitin 2019 të përmbyllet, sa i përket asaj se çka ka në Drenoc, aty janë tre rrugë dhe dy segmente të kanalizimit, rruga e Kastratëve, Gashit dhe rruga te varrezat e Berishëve, kurse kanalizimet janë tek Hamide Makshana që lidhet me pjesën tek xhamia, dhe kanalizimi i Halim Zyberaj deri tek Berhan Gashi, pra kjo është e specifikuar me segmente por unë që të jem më i qartë po ju tregoj edhe me emra të lagjes. I nderuar z. Vahit sa i përket ndërtimit të semaforëve të ri në kemi menduar sikurse që janë modelet në Prishtinë, pra semaforët që janë mbi kornizë dhe që tregojnë se nga duhet të shkojnë makinat, sepse ne si qytet i kemi shumë rrugët e ngushta dhe kur vinë makineritë e mëdha të huaja nuk e dinë nga duhet që të orientohen, pra këtë mundësi e kanë semaforët e ri në sepse në ta vendosen tabelat orientuese. Pastaj sa i përket rreth rrotullimit tek hotel Jaha, kemi kërkuar një sqarim nga Ministria e Infrastrukturës dhe sipas tyre nuk lejohet në atë pjesë të ndërtohet rreth rrotullimi, ne kemi vendosur që aty të vendosim semaforët e ri në sepse është mbi 2.5 % pjerrtësi dhe për këtë arsye rreth rrotullimi nuk lejohet me standarde të këtij niveli. Kurse kur jemi tek krijimit të parkingjeve të reja z. Dervish Çadraku ma ka kopjuar idenë sepse në KPF e kam dhënë këtë sqarim, ne në rrugën “Xhelal Hajda- Toni” do të krijojmë në të dy anë parkingje zik- zake, ku do të vendosen tabelat informuese se sa kohë munden të qëndrojnë të parkuar, dhe me këtë besoj se do të lirohet rruga. E nderuara znj. Mirjeta Krasniqi këtë vite në komunën e Rahovecit do të futen disa rrugë për tu ndërtuar, dhe njëra prej tyre është edhe rruga e lagjes së Meseleve në fshatin Pastasel. Kurse sa i përket çështjes së ujit të pijes ne jemi në fazën kur ka fundi i muajit tetor do të përmbyllet faza me ujë të pijes për fshatrat Polluzh dhe Guri të Kuq, me mundësi vazhdimi përmes marrëveshjes që e kemi me KRU- Radionqi, që të vendosim edhe ujin e pijes në fshatin Pastasel, por e gjitha varet nga ata se sa kanë mundësi buxhetore që të gjitha këto të i kryej këtë vit. Kurse për mirëmbajtje të hapësirave publike desha të ju njoftoj se punëtorët sezonal e kanë kontratën vetëm për 3 muaj e jo më gjatë, ne këtë vite kemi pasur shumë të reshura ku është dashur që të ndërhyrë në 3-4 pozicione dhe është dashur që 3-4 herë të pastrohen varrezat e jo vetëm një herë siç ka qenë e kontraktuar vetëm një herë. Ne tani këtë pjesën e pastrimit e kemi ndarë në tri lë loto, ku ju janë dhënë mundësi tri operatorëve që të kujdesen për këto hapësira publike. I nderuari z. Munib Durguti pyeti për ndriçimin publik tek rruga “Gëzim Hamza – Piktori”, i nderuar ne përveç ndërtimit që i kemi në 10 lokalitete, e kemi edhe zgjerimin publik në qytet, në pjesën e epërme janë disa lagje që nuk janë fare të ndriçuara dhe duhet urgjentisht të ndriçohen, besoj se edhe në këtë rrugë do të vendosim ndriçimin publik sepse kjo rrugë nuk është shumë e gjatë. I nderuari z. Fehmi Cena rruga Drenoc – Zatriq, është projekt i trashëguar nga viti 2016, ku projekti ka përfunduar në masën prej 95%, ne edhe nga auditori i jashtëm e kemi që kontratat që janë duhet që të përmbyllen, obligimet e tjera që i kemi për kontrata që janë të cekura në tabelar janë vazhdimësi e projekteve. Sa i përket investimeve në varreza dikush e tha që pak punë shumë, pare, jo i nderuar nuk janë shumë pare, vlera është diku rreth 56,000.00 € për tri operator vlen kjo shumë, siç e ceka edhe më parë se pastrimi i varrezave këtë vite nuk është bërë vetëm një herë por deri në 3 herë,,

kurse në kontratë një herë ka qenë e paraparë. E nderuara znj. Fahrije Lushi po ju njoftoj zyrtarisht se në fshatin Malësi e Vogël do të ndërtohet një trotuar dhe një parking afër shkollë fillore, ky projekt është në procedurë të prokurimit. Po ashtu edhe tek objekti i AMF-së do të ndërtohet një parking dhe me këtë do të mbulohet me trotuarin që është në vazhdimësi të pjesës së fshatit. Z. Trajko Shariq pyeti për ujin e pijes në fshatin Hoçë e Madhe, i nderuar ne jemi në koordinim me KRU-Gjakovën, ku kemi kërkuar projekte të zgjerimit të kapaciteteve për ujë të pijes, njëra ndër ta është edhe projekti i cili do r lidh Hoçën e Madh, Zoqishtin dhe Opterushën, besoj se shumë shpejtë nëse planifikojnë ata buxhet ne në vitin e ardhshëm do ta realizojmë këtë projekt dhe do të sigurohet uji i pijes për këto 3 vendbanime. Sa i përket projektit të impiantit, i nderuari z. Dervish Çadraku, e kam shpjeguar edhe në KPF se impiantet janë projektet e kushtueshme, duhet që gjithë planifikimi i buxhetit të komunë së Rahovecit për 10 vite të mbledhet për një impiant, ne në një të ardhme patjetër duhet që ti planifikojmë këto projekte, por tani komuna e Rahovecit nuk e ka këtë mundësi. Ne e kemi një projekt për kolektor, por funksioni i kolektorit është vetëm mbledhja e këtyre kanalizimeve kurse derdhja do të mbetet përsëri e njëjtë. Kurse sa i përket hapjeve të gropave septike besoj se ato nuk e zgjidhin problemin. Sa i përket ndërtimit të trotuareve, shesheve, rrugëve, ne si komunë kemi planifikuar diçka edhe në Malësi edhe në vendbanimet që janë me prioritet të lartë, po ju njoftoj se edhe në Sopniq rruga që të qon në Fortesë e kemi planifikuar një buxhet për ndërtim të trotuareve, pastaj në Celin nga rruga kryesore deri tek shkolla. E nderuara znj. Vjosa Isma sa i përket projektit për pjesën e vjetër të qytetit, ky projekt është duke vazhduar dhe janë duke punuar në këtë rrugë, besoj se këtë vite do të përfundoj ky projekt.

Dervish Çadraku – E di që në histori shpesh herë kanë ndodhur që shpikjet njëkohësisht nga dy vendet diametralisht krejt të kundërta, pra ka mundur të ndodhë një shpikje në Australi, por e njëjta shpikje të ndodhë edhe në Kubë, prandaj ti mundesh me thanë që unë ta kam vjedhur idenë, por në atë kohë kur janë vendosur sferat unë kam thënë se nuk është në rregull, sepse ato e kanë zënë shumë hapësirën. Pastaj nëse ti mendon për atë rrugë, unë po të gjejë një vend tjetër për parkingje por mos thuaj pastaj jo se unë kam qenë i pari ai që e kam menduar këtë, tek ish gjimnazi mundet të ndërtohet një parking nëntokësor, kjo ishte ideja ime i nderuar e jo e jotja.

Rumir Zhuniqi – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, i nderuari z. Vahid Krasniqi, projekti për rregullimin e lumit Rimnik është projekt në vazhdim i cili ka filluar në vitin 2016, tani është faza e dytë e këtij projekti, janë bdarë 15,000.00 € për vitin 2019 dhe me këtë synohet që ky projekt të mbyllet. Pastaj ishte një pyetje nga z. Munib Durguti, i nderuar ne kemi planifikuar për vitin 2019 një buxhet prej 40,000.00 € nga grandit qeveritar, e dimë se ky buxhet nuk është i mjaftueshëm për ta përfunduar në tërësi, por ne synojmë që me ridestininim të mjeteve ky projekt të përfundoj në aspektin financiar. Kurse sa i përket projektit të Kompleksit të dëshmorëve në Gradish, i nderuar z. Fehmi Cena, kompleks na shërben neve për ta ruajtur memorien e historisë së luftës së fundit, ky projekt ka filluar në vitin 2012 dhe është punuar vetëm deri në vitin 2013, më nuk është punuar në këtë projekt, kurse ne tani synojmë që në vitin 2019 ti rikthejmë punimet në këtë kompleks dhe të përfundojnë të gjitha punimet.

Samir Mustafa – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, i nderuar z. Munib Durguti, sa i përket projektit Vitalizimi Infrastrukturës për Funkcionalizimin e Projektit Shtretërit Shtëpiak, ky projekt është në bashkëpunim me CARITAS – Kosovën, siç e dini ky projekt financohet nga kodi mallrave dhe shërbimeve, kurse për vitin 2019 është planifikuar nga Kosi i Investimeve kapitale, ngase shumica e komunave të Kosovës e kanë nga ky kod. Kurse sa i përket ashensorit i nderuar ai është funksional dhe nuk e mendoj se duhet që të bëhet ndonjë investim tjetër aty, fokusimi kryesor për vitin 2019 do të jetë përfundim i QKMF-së, siç e dini faza e parë e projektit ka përfunduar, ne e kemi shpallur tenderin për fazën e dytë, presim tani që kompania cila e fiton tenderit të ja fillon punimet. I nderuari z. Fehmi cena parashtroi një pyetje sa i përket të hyrave vetanake në QKMF, ne e dimë se kemi probleme rreth realizimit të hyrave vetanake në QKMF, besoj se për vitin tjetër së bashku edhe m z. Fehmi Cenën do të bëjmë një plan më konkret për rritjen ose realizimin e të hyrave vetanake. Sa i përket Dezinsektimi, dezinfektimi dhe deratizimi është

projekt i cili vazhdon edhe për vitin 2019. Sa i përket ndërtimit të një objekti për qëndrim ditor për të sëmurë mentalë është pak problem që të realizohet kjo e dini edhe ju vetë këtë doktor. Kurse sa i përket problemeve në liberatorin e analizave, i nderuar z. Çadraku është e vërtet se kemi pak probleme, shumë shpejtë brenda jave presim që të shpallim një tender për blerje të një aparati laboratorik. Pastaj i nderuar e potencuat se AMF-ja në Polluzhë nuk është funksionale, besojmë se javën e ardhme kjo AMF do të jetë funksionale.

Berat Duraku – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, kryesisht pyetje për Drejtorinë e Bujqësisë ishin nga z. Rasim Fazliu. Po ja filloj nga e pyetja e parë që ishte rreth rrugëve fushore, ku kërkuat që të specifikohet se cilat rrugë do të shtrohen, edhe në KPF ju kemi treguar se në drejtorinë e bujqësisë na kanë ardhur 48 kërkesa sa i përket rrugëve fushore, ku nga të gjitha kërkesat i kemi mbledhur na dele që diku rreth 74 km rrugë duhet të shtrohen sipas kërkesave të banorëve. Sa për informacion projekti i ndërtimit të rrugëve fushore është projekt i vjetër ose në vazhdim, ku nga ky projekt kemi një borxh të trashëguar me vlerë prej 121,384.00 €, këtë borxhe kemi planifikuar që të kryejmë në vitin e ardhshëm, pra sipas kësaj i bie që për ndërtimin e rrugëve të reja fushore na mbetin vetëm 70,000.00 €. Po ashtu dua të ju njoftoj se sa i përket rrugëve fushore ne jemi në pritje të lidhjes së një kontrate me MBZHR-në, ku projekti e ka vlerën prej 1,000,000.00 €, ku kryesisht do të trajtohen rrugët vreshtave, ku për vitin 2019 janë të specifikuar në projekte si rruga Olt – Maqinë rreth 7.5 km, rruga nga trafo e Stoine Castle në drejtim të Pallaticës, pastaj rruga në drejtim të varrezave të Shtavicës dhe rruga tek Rimniki i Kasumëve në drejtim të Pallaticës. Prandaj nëse ne i përcaktojmë prioritetet nga tani do të biem ndesh me këto nga ministria, prandaj prioritet e rrugëve fushore për vitin 2019 di ti përcaktojmë së bashku me juve kuvendar dhe me kryetarët e fshatrave dhe lagjeve urbane. Sa përket hapjes së kodeve të reja buxhetore për përkrahjen e fermerëve, të gjitha këto do të kalojnë përmes procedurës së zyrës së prokurimit, këto nuk mundin të trajtohen sikurse subvencione për arsye se ne nuk do japim mjete financiare fermerëve por do ju shpërndajmë pajisje. Ne këtë e kemi ndarë në disa kategori, p.sh në perim-kulturë do të ndahen disa traktorë – benas, stërpikës, freza, plug, makina, për patate, makina për çep, makina mjelëse për specat etj. Kurse në sektorin e blegtorisë është caktuar që të bëhet thirrja për makina mjelëse, laktofriz, enë të tjera për trajtim të qumështit etj. pastaj në sektorin e bletarisë, kemi vendosur që të ndajmë koshere për bletë, enë për trajtim të mjaltit dhe gjitha pajisjet e tjera që janë të nevojshme për këtë sektor. Për përpunues të rrushit kemi paraparë: Enë të inoksit, shtyllës të rrushit, kazanë për pjekje dhe gjërat e tjera të nevojshme. Po ashtu edhe për prodhuesit e perimeve kemi paraparë që të i ndajmë: Komore të vogla ftohëse për ruajtjen e perimeve dhe produkteve të tyre, pajisje për pjekje, grirje dhe bluarje etj.

Vahid Krasniqi – I nderuari z. Përparim Krasniqi e dha arsyen e vetë për nderimin me semaforëve, di shumë mirë se çka flasë sepse kam ndjekur trajnime edhe në Beograd për semaforë, ka semaforë prej 250,000.00 € për një udhëkryq, Rahoveci si qytet asnjë rrugë nuk e ka me dy shirita për një kaheje, të gjitha rrugët i ka me një shirit, prandaj po e them se këto semaforë janë të favorshëm. Kurse sa i përket orientimit të rrugëve është sinjalizuesi vertikal që emëron rrugët ose epiqendrën për me i dhënë orientim qytetit, prandaj mendoj se shuma prej 20,000.00 € nuk është e nevojshme të ndahet për semaforë, ajo që ka nevojë këtu është të ndryshohet faza dhe cikli i këtyre semaforëve. Pastaj sa i përket parkingjeve, le të më thotë mua drejtori se e ka bërë një projekt për parkingje të reja, që të ndahet njëshme për parkingje së pari duhet që të bëhet hulumtimi, nuk guxon të hiqet trotuari ashtu siç mendoni ju sepse është një masë e sigurisë ku nuk guxon të zvogëlohet trotuari në qytet, pastaj pasi të bëhet hulumtimi duhet të caktohet se në çfarë shkallë do të ndërtohen parkingjet, e tek pastaj të ndahen mjetet, e jo të ndahet shuma prej 180,000.00 € për parkingje kurse nuk e dinë koston se sa do të kushton ai projekt.

Rasim Fazliu – Desha të ja rikujtoj drejtorit se ne jemi duke u munduar që të kontribuojmë në mënyrë që të dele tamam një buxhet ashtu siç duhet, ky është qëllimi asgjë më shumë. Ne e dimë të gjithë se përgatitja e buxhetit fillon qysh në fillim të muajit qershor, konsideroj se drejtorët tanë kanë pasur kohë të mjaftueshme qysh nga muaji qershor e deri më tani që i identifikojnë 2-3 rrugë pasi p thoni se nuk ka shumë

mjete. Sa i përket asaj që e the se ju kam treguar edhe në KPF, ju i nderuar drejtor na keni treguar që janë 48 rrugë ose kërkesa, por unë kam kërkuar që të specifikohen nga këto 48 rrugë se cilat janë më me prioritet. Sa i përket atyre projekteve unë e them se ato nuk i takojnë investimeve kapitale, kurse ju e thoni që po i takojnë, atëherë mendoj se ne duhet që të kemi këtu një ndërmjetësues. Do ju lexoj diçka, ligji për financa publike e thotë qartë: Investimet kapitale për financa publike sipas ligjit në përfundim të projektit konsiderohen ato që mbeten si kapital, pra si inventar që mbetet aty, pra të regjistrohen si aset publik. Ndërsa nëse mua më ka dhënë disa kilogram farë komuna atëherë si ta regjistroj unë atë si aset, prandaj ju lutem duhet që të jemi të qartë në këtë drejtim dhe të dimë se çka janë për investime kapitale dhe çka janë për shërbime ose subvencione etj.

Kryetari – Fillimisht ju falënderoj të gjithëve për kontributin e dhënë gjatë debatimit të çështjes e cila ka të bëjë me aprovimin e një dokumenti më të rëndësishëm që e ka një komunë e caktuar, në rastin konkret komuna jonë, e ajo është KAB-it 2019-2021. Në e keni edhe listën e prioritetëve të komunës sonë për vitin 2019-2021, kemi mare shumë këshilla nga an e juaj, po ashtu mendoj se bashkëpunëtorët e mijë janë munduar që të ju sqarojnë disa nga çështjet të cilat u ngritën në këtë debat. Së pari falënderoj anëtarët e KPF-së të cilët kanë vazhduar takimet ashtu siç i takojnë me ligj, ku e kanë dhënë kontributin e tyre në adresimin e shqetësimeve, kërkesave, nevojave dhe të interesave të qytetarëve të komunës së Rahovecit. Gjithsesi një falënderim i shkon edhe bashkëpunëtorëve të mijë të cilët marrin pjesë në plotë debate, dëgjime dhe pranojnë shumë shqetësime, letra, shkresa, nga qytetarët e komunës, ajo që desha të them është se edhe ne jemi çdo ditë në aktivitete dhe jemi në komunikim të përditshëm me qytetar, ashtu siç jeni edhe ju. E vërteta është se ka rritje të buxhetit në përgjithësi, dhe kjo rritje vazhdon që të jetë standarde, ndonjë herë më pak e ndonjëherë më shumë e gjitha varet prej asaj që e përcaktojnë kushtet dhe rrethanat konkrete me të cilat gjendet komuna jonë, por edhe MF e cila kujdeset që ti artikuloj ose që ti sanksionoj disa tavane ose limite buxhetore. Buxheti për mallra dhe shërbime është rritur në të gjitha komunat e republikës së Kosovës, për arsye se të gjithë kryetarët e komunave si të mandatit të kaluar ashtu edhe të këtij mandati, kanë kërkuar që ky kod të rritet. Mendoj se ne sa më parë që të arrijmë në pozicionin që shumica e buxhetit të shkojë në mirëmbajtje të krejt asaj që është ndërtuar, atëherë do të konsiderohet se standardi ynë i jetesës dhe i zhvillimit bukur i lartë. Ne gjatë debateve publike kemi dëgjuar hallet dhe shqetësimet e qytetarëve që lidhen nga ato që janë kërkesa themelore si për rrugë, rrugica, sheshe, ujë të pijes, trajtim të ujërave të zeza etj. Zotimi i gjithë neve ka qenë që sa më shpejtë të jetë e mundur të i përmbysim investimet në ciklin e infrastrukturës publike, pastaj do të kemi më lehtë që të bëjmë kapërcimin cilësor për të hyrë në projekt e të cilat kanë bazë në punësim ose në zhvillim. Të nderuar një pjesë e madhe e buxhetit për investime kapitale, fatbardhësisht apo fatkeqësisht është duke shkuar në infrastrukturë publike, si në rrugë, kanalizime, trotuare, ndriçim publik, ose në projektet të cilat ndikojnë rritjen e cilësisë së jetës së qytetarëve. Po ashtu i kemi kushtuar rëndësi përmbushjes së obligimeve që dalin nga marrëdhëniet kontraktuale që i ka krijuar komuna jonë në vitet e kaluara, pra e kemi ruajtur me fanatizëm traditën e vazhdimësisë sepse janë kontratat e lidhura, vetëm le të më thotë dikush se një kontratë është anashkaluar, pastaj unë sigurisht do ti bëjë thirrje që mos të aprovohet KAB-i për vitet 2019-2021. Kjo mundet të ndodhë vetëm nëse neve na thonë mekanizmat e kontrollit se në këtë kontratë të keni kujdes, dhe na rekomandojnë që atë kontratë ta shkëpusim, kjo vetëm atëherë mundet të ndodhë. Ne kemi kërkesë dhe rekomandim nga auditori jashtëm, zyra kombëtare e auditimit që të i përmbushim obligimet e krijuara nga komuna e Rahovecit, qofshin ato marrëdhënie kontraktuale apo obligime financiare, pra ne me planifikimin e vitit 2019 kemi synuar jo shlyerjen e të gjitha obligimeve sepse kjo nuk është e mundur, por ne diku rreth 26% të buxhetit për vitin 2019 kemi mbërritur me i hapë kodet e reja, edhe pse ne dhe ju kishim pas dëshirë që të hapen sa më shumë kode të reja, por mundësitë janë të kufizuara. Me kujdesin më të madhe unë e kam pranuar një dosje nga kryesuesi nga dëgjimet publike që i keni mbajtur, dhe ju siguroj të gjithë juve këtu se 99.98% janë të përfshira shqetësimet, kërkesat, nevojat dhe interesat e komuniteti të cilat i keni pranuar ju gjatë dëgjimeve publike, e që ne i kemi mare pak para jush gjatë debateve publike që i kemi mbajtur nëpër fshatra dhe lagje

të komunës së Rahovecit. Do përpiqem tani që të ju japë sqarime të gjithë juve për ato pyetje që i parashtruat deri më tani, të nderuar disa prej rrugëve, trotuareve ose përmirësime në kanalizime të cilat mundeni të i shihni, por edhe mundeni të mos të shihni, sepse dikush e tha se mundeni të fshihen pas kodeve të përgjithshme, të nderuar kjo nuk do të ndodhë, disa prej atyre që i përmenda më parë do të ndërtohen këtë vite, disa janë vetëm në procedurë, pastaj lind pyetje a kemi mjete të mjaftueshme, përgjigjja ime është jo, e kemi shfrytëzuar kodin e vjetër sepse ju e dini që nuk kemi të drejtë me hapë kode të reja. Ne kemi tentuar që të përfshimë rrugët të cilat janë me prioritet më të lartë dhe të ndërtohen këtë vit, pastaj disa kanalizime janë duke u trajtuar qysh këtë vit, pra janë në procedurë të prokurimit. Lindë pyetje pse e kemi ruajtur kodin e përgjithshëm, e kemi bërë sepse ne nuk mundemi të bënim një listë ku do të specifikonim specifika ose veçantit të secilit projekt me emërtim sepse atëherë do të dilte KAB-i shumë voluminoz, për vete e di se ashtu siç propozoi z. Rasim Fazliu e di që do të ishte më mirë, por këtë vite besoni se është tepër vështirë për shkak të vështirësive që janë të natyrshme. Të nderuar ne nuk mundemi të hymë në projekte të reja, me kode të reja, për arsye se nuk guxojmë me të anashkalojmë atë që e tha qysh në fillim z. Rasim Fazliu se duhet që të respektohen kontratat të cilat janë në fuqi. Të nderuar desha të cekim se komuna jonë dhe komunat e tjera të republikës së Kosovës, në takimin që e kemi pasur me kryetarët e komunave kemi parë se do të ketë bukur sfida mbledhja e tatimit në tokë, sepse kjo është duke u aplikuar për herë të parë, prandaj ne nga kjo pikëpamje jemi duka paraparë rritje të të hyrave, por nuk do të thotë se nëse do të kemi probleme mos të ja fillojmë fare, këtë e kemi obligim ligjor dhe është një vendim i qeverisë së republikës së Kosovës që komunat të ja fillojnë mbledhjen e inkasimit në tokë. Sa i përket planit për menaxhimin e mbeturinave e sqaroi z. Përparim Krasniqi, por përveç Xhajkës tani ka hyrë me kontributet e vete edhe GIZI gjerman, ne e kemi planin i cili është miratuar në Kuvendin e Komunës, por shpresoj se do të kemi pak më shumë rezultate për sa i takon trajtimin të menaxhimit të mbeturinave të ngurta, ky kuvend e ka gjetur edhe lokacionin se ku do të vendosen mbeturinat e ngurta. Sa i përket Planit të detajuar të buxhetit gjinor, është e vërtetë që ka kërkesa për buxhetimin gjinor, mendoj se nuk është mirë e specifikuar sepse komuna e Rahovecit ka filluar që ti pranojë përgjegjësit dhe detyrat për të bërë buxhetimin gjinor, pra nuk mund të themi se është e papërgjegjshme kur shkruan se është gabim. Ne tani me këto mundësi që i kemi më direkt do të kujdesemi që ndoshta me bartjen e të hyrave ose me rishikim të buxhetit do të kujdesemi që ti shtojmë përkushtimet dhe të kërkojmë më shumë rezultate për buxhetimin gjinor dhe planin e detajuar se si do të buxhetohet kjo kategori. Pastaj kishte propozime për heqjen e disa projekteve nga investimet kapitale dhe kalimi i tyre në mallra dhe shërbime, mendoj se për këtë është diskutuar mjaftë, prandaj ju lusë duke filluar në z. Rasim Fazliu e deri tek ata që munden të kontribuojnë, ne i kishim disa argumente, po ashtu edhe z. Rasim Fazliu i kishte disa argumente, pastaj z. Rasim Fazliu beson në diçka, por edhe ne besojmë në diçka, prandaj propozoj që këtë të ja lëmë zyrës kombëtare të auditimit që të jepe përgjigje në raportin për vitin 2018 që ne shpresojmë të dele i pamodifikuar. I di saktë të gjeturat e auditorit të jashtëm dhe nuk bëhet fjalë për këtë që jemi duke biseduar, por bëhet fjalë për një kategori tjetër, ju e dini shumë mirë se shpenzimet e varrimit janë subvencionuar nga kategoria e subvencioneve, kurse tani me vendim të kuvendit këto janë bartur tek kategoria e mallrave dhe shërbimeve, shumë mirë që është bërë kjo dhe nuk dua të shkojë më tutje, por mos harroni çdo raporte që vije nga zyra e auditorëve të jashtëm është objekt për hetime të prokurorisë, në këtë rast nëse kam gabuar me kënaqësi e kisha pranuar hetimin nga prokuroria. Prandaj mendoj se nëse flasim për një mirëqenie sa më të mirë për fermerët tan, këto kategori për të cilat u kërkuar që të bëhet ky transferim nga një kategori në kategori tjetër, megjithatë kanë një bazë zhvillimore, sepse jemi duke biseduar për veprime konkrete të cilat do të ndodhin gjatë përmbushjes së një kontrate e cila do të lidhet me zyrën e prokurimit e jo me zyrën e kryetarit të komunës. Ministria e Bujqësisë ka një traditë të trajtimit të projekteve me bashkëfinancim mes GLV, Ministria e Bujqësisë dhe Komuna e Rahovecit, kjo mundet të ndodhë këtë vite, por le të themi se këtë vite është investim kapital kur është në pyetje mbështetja e projekteve me bashkëfinancim tek drejtorja e bujqësisë. Do të vendoset rrjeta rrugës për Malishevë për mbrojtje të mbeturinave, do të investohet edhe në dy projekte të tjera me një shumë të caktuar që e jepe

Ministria e Bujqësisë përmes agjensionit për zhvillimin e bujqësisë komunës së Rahovecit ku është edhe GLV-ja, pra këto janë investime kapitale edhe pse thirret mbështetja e projekteve me bashkëfinancim. I kemi kushtuar kujdes trajtimit të shtretërve të lumenjve dhe kullimit të tokave bujqësore, ne e kemi një situatë që me projekte të cilat kontratat janë ende në fuqi, kullimi i tokave bujqësore Ratkoc, Malësi e Vogël, Gexhe etj. E kemi kontratën për lumin Dullo që po synojmë ta mbyllim, pastaj e kemi kompleksin e Gradishit, pra i kemi disa projekte të cilat ne duhet që ti mbyllim sa ma shpejtë që është e mundur sepse është kërkesë e auditorit. Ne kemi pasur një vit të rëndë me vërshime, reshje të shumta dhe me dalje të lumenjve nga shtrati, ne besojmë se në listën e prioriteteve të larta janë edhe kullimi i tokave bujqësore, disa vetëm ja kanë filluar, do të kemi situata të këtilla edhe në të ardhmen, sidomos në shtratin problematik i cili e ndanë Krushen e Madhe me Celin, shumë shpejtë edhe aty do të kemi aktivitete por shpresojmë se procedurat e prokurimit nuk do vonohen. Sa i takon semaforëve, parkingjeve të reja, ju lutem asnjë veprim sot në Komunën tonë nuk do të bëhet pa ekspertizë. Kur kemi folur për semaforë kemi thënë: Semaforët ekzistues nuk janë të mjaftueshëm, po ashtu ky është edhe mendimi i shumë qytetarëve se me një palë semaforë që janë nga koha e fashizmit nuk shkon. Pastaj a duhet të bëjmë rreth rrotullime, a duhet të vendosim shenjzime vertikale dhe horizontale, por ajo që e di është se ne duhet të japim një zgjidhje, p.sh tek palestra aty tek ai udhëkryq ka diçka nevojë të bëhet, pastaj ne duhet që të japim zgjidhje tek ura e lumit Dullo tek ura e Ali Agës, pra ne duhet që të japim një mesazh se qyteti i Rahovecit po transformohet edhe në këtë sferë. Parkingjet e reja nuk do të munden të bëhen pa projekt, as pa ekspertizë dhe as pa këshillat e veçantë sikurse që i morëm nga z. Vahid Krasniqi, projektet nuk do i bëjë unë dhe as bashkëpunëtorët e mijë, ne shumë shpejtë do e lidhim një kontratë me kompaninë për hartimin e projekteve. Projektet të cilat kanë të bëjnë me jetën e njerëzve, sigurisht se për ato projekte do të mbahen edhe dëgjime publike, por shpresoj se nuk do të ndodhë sikurse që ka ndodhur në debatin publik për shtëpinë muze të “Ukshin Hotit” ku anë mare pjesë një numër shumë i vogël i qytetarëve. Pra ju siguroj se pa planë asgjë nuk do të ndodhë në Komunën e Rahovecit, pra gjithçka do të shkoj sipas standardeve, kjo është kërkesë edhe e jona por edhe e atyre që janë duke na monitoruar. Sa i përket ashensorit në QKMF, besoni se mua hiq nuk më ka shkuar mendja që të ndërtoj një ashensor në QKMF edhe pse ai ka mundësi që të ketë telashe dhe të i nënshtrohet riparimit, ajo që më ka shkuar mua në mendje është që të ndërtoj një ashensor këtu në këtë objekt ku jemi tani, është shumë e çuditshme se si nuk është paraparë një ashensor në këtë objekt, unë si kryetar nuk po kam mundësi që ti pres në zyre njerëzit që janë në karrocë, mendoj se një ashensor duhet që të jetë në objektin e komunës, duhet që të shikojmë mundësin nëse mundemi me rishikim të buxhetit të hapim një kod. Grandi specifik i shëndetësisë nuk është duke u marr, objekti i cili është në përfundime sipër për banim, aspak nuk i plotëson nevojat së paku në bazë të kërkesave që janë duke i bërë njerëzi në nevojë, natyrisht se fondi është i pamjaftueshëm edhe ky që është planifikuar, po ne jemi duke shpresuar që së bashku me donatorë do të mbërrimë të ndërtojmë së paku disa prioritete të larta dhe njerëzve në nevojë të i dallim në ndihmë. Sa i përket monumenteve të trashëgimisë kulturore, restaurimi i tyre etj. Ato kroje që i përmendi znj. Vjosa Isma tek Sheshi i Republikës, e nderuar procedurat e prokurimit kanë filluar, tani të gjitha krojet në qytet dhe monumentet e kësaj natyre do të trajtohen këtë vit. Sa i takon Sahat Kullës, aty ka pasur investime dhe restaurime vazhdimisht, por aty ka probleme me prona dhe çështja është shumë më e thellë se sa ne jemi duke menduar, prandaj zgjerimi i oborrit implikon edhe çështjet e tjera të cilat ndoshta nuk janë për tu diskutuar sot. Numri i nxënësve është e vërtet se është duke rënë, por ja që në disa fshatra po rritet, por kjo nuk do të thotë që do të bie edhe numri i bizneseve, pra munden të rriten bizneset e reja, sepse edhe lufta kundër informalitetit mundet të ndikojë që të regjistrohen më shumë biznese sepse do të kenë interes më të madh kur janë të regjistruar, pra ne llogarisim se numri i bizneseve do të rritet për 600-700 biznese. Sa i përket shkollave ne nuk mundemi ta mbajmë brenda një viti barrën e hapjes së kodeve të ndërtimit të shkollave, mos të harrojmë këtë vit e kemi shkollën Hoçë të Vogël, Brestoc dhe shkollën në Retij, vitin e ardhshëm e kemi planifikuar ndërtimin e shkollës në Fortesë, pastaj kemi disa shkolla të cilat trajtohen përmes projektit për energji eficiente, dhe shpresojmë se do ta risim këtë numër. Por kjo nuk do të

thotë se edhe shkolla në Xërxë nuk do të futet shumë shpejtë, ne jemi duke shpresuar se MASHT-i dhe MAP-i, ashtu siç është duke ndërtuar shkollën “7- Shtatori dhe Çerdhen e fëmijëve në Rahovec, shpresojmë se do të marrim parë mbështetje si nga qeveria ashtu edhe nga donatorët e jashtëm për ndërtimin e çerdheve dhe shkollave të reja, prandaj edhe unë jam i atij mendimi se buxheti i komunës duhet që të orientohet më shumë në renovimin dhe rehabilitimin e shkollave ekzistuese, por mos harroni se edhe në kode të vjetra por edhe në kode të reja keni projekte për meremetimin dhe renovimin e objekteve. Desha të i përgjigjem dikujt që e tha se është duke u vërejtur mungesa e drejtorit të financave, por dua të ju them se drejtorët që janë këtu jam i bindur se janë në gjendje me ju specifiku të gjitha se ku dhe çka do të ndodhë sipas këtij buxheti, sepse të gjitha i kanë të shënuara, ky buxhet me të metat dhe përpjesëtim që i ka është vepër e gjithë neve me në krye me z. Afrim Limanin. Edhe një herë ju kisha ftuar që ta aprovonin KAB-in 2019-2021, përkatësisht buxhetin për vitin 2019 dhe listën e projekteve kapitale, në të cilat janë kodet e vjetra dhe kodet e reja.

Rasim Fazliu – Pajtohem plotësisht me kryetarin se këto projekte janë të mirëseardhura, por ne e cekem se këto projekte vetëm se janë keq klasifikuar në kategorinë e investimeve kapitale, ju lutem së paku pranojeni që nuk janë pjesë e kategorisë së investimeve kapitale. Nëse ndryshohet kjo atëherë mundemi që të diskutojmë dhe të konsultohemi për më tutje. Kur ishte fjala tek projektet me emërtime të përgjithshme edhe në KPF kam thënë le të mbesin kodet ashtu siç janë, por kishte me qenë mirë që të dele drejtori në foltore dhe të na tregoj neve se brenda këtij kodi ku janë të ndarë kaq mjete do të bëhet kjo dhe kjo, pastaj kjo do të regjistrohet në procesverbal, po ashtu edhe qytetarët do të dëgjojnë se çka do të ndërtohet në komunën e tyre, mendoj se ne nuk kemi qëllime të këqija, ne jemi të gjithë për miratim të buxhetit, por vetëm jemi duke kërkuar që të miratohet në mënyrën më të mirë.

Kryetari – I nderuari z. Rasim Fazliu, nuk ka kurrfarë problemi në mundemi të ju prezantojmë edhe ashtu siç po thua ti, por më duket se mjaftë debate ka pasur, po ashtu mendoj se z. Përparim Krasniqi në sferën e shërbimeve publike tregoi se ku do të investohet. E dëgjova vetë kur i ceku 3- 4 rrugë që do të ndërtohen, mundet të ndodhë që njerëzit mos ta dinë, por ne e dimë se ku është duke u ndërtuar sepse është një kontratë e trashëguar. Janë hapur procedurat tani për 9 rrugë, besoj se nuk ka kurrfarë problemi nëse ne i tregojmë se cilat janë ato 9 rrugë, pastaj është hapur procedurë për ndërtimin trotuareve, shumë lehtë dhe qartë e ka drejtori i shërbimeve publike dhe nëse dëshironi edhe me shkrim do ju jepe se cilat vende janë me prioritet të lartë, me këtë besoj se jemi në rregull. U përmendën rrugët fushore, është e vërtetë se rrugët fushore – vreshtarë, jemi duke pritur lajm nga ministria sepse të gjitha rrugët vreshtarë janë kategorizuar nga Ministria e Bujqësisë, kurse sa i përket rrugëve të tjera neve vetëm 70,000.00 € na mbesin sepse mjetet tjera janë të destinuar për shlyerjen e borxheve ndaj kompanisë që i kemi. Por të jeni të sigurtë se rrugët fushore do të trajtohen me prioritet nga komuna sepse këtë po ta imponojnë fermerët, kudo që shkojmë i kemi këto kërkesa nga fermerët. Pra kur flasim për projekte konkrete të nderuar është një listë e gjatë e shqetësimeve, dhe po ju siguroj se kërkesat që dalin nga ky kuvend dhe që janë me prioritet qoftë për një vendbanim edhe më të vogël, do të trajtohet me kujdes kur bëhet një kërkesë nga shefat e grupeve të kuvendarëve ose edhe një kuvendar i vetëm, por ne nuk mundemi që ti fusim në renditje sepse janë shumë kode, nëse ne hapim shumë kode të reja atëherë neve si qeveri do na sulmojë auditori, dhe ne këtë nuk e dëshirojmë, duam që ti shmangemi këtij problemi. Edhe një herë po ju ftoj që ta votoni dokumentin më të rëndësishëm të komunës sonë KAB-in 2019-2021.

Fehmi Cena – Ne këto debate dhe diskutime që jemi duke i bërë dikujt munden të i duken të tej zgjatura, por mendoj se nuk janë të tej zgjatura, për arsye se është fjala për një pikë të rëndësishme të rendit të ditës, prandaj të gjithë po ashtu edhe qytetarët duhet të kuptojnë se qëllimi ynë është që të kontribuojmë në mënyrë që të dele një buxhet sa më i arsyeshëm, po ashtu edhe shpërndarja e buxhetit të jetë sa më e arsyeshme. Është e vërtetë që ne kemi qenë pjesë e dëgjimeve publike, ku i kemi dëgjuar edhe kërkesat e qytetarëve, këtë jemi duke e mare parasysh, po ashtu jemi duke mare parasysh edhe diskutimet që i kemi bërë ne si kuvendarë, po ashtu edhe kërkesat që i kemi bërë më parë. Kërkesat e jona si grupe i LDK-së ishin të qarta dhe nuk e besoj se nuk munden të bëhen ose përfshihen në kodet e reja, nëse fshati Pastasel

nuk përmendet askund atëherë le të përfshihet në një kod, mendoj se kjo nuk është diçka e pamundur. U përmenden edhe rrugët, uji i pijes, trotuaret, pra këtu nuk ceket, prandaj propozoj që këto të futen në kodin 43471, pra nuk besoj se bie në kundërshtim nëse shtohet edhe fshati Pastasel.

Kryetari – I nderuar ky që e propozuar është kodi i vjetër, aty nuk kemi mundësi me futë, por në një kod të ri mundmi me e futë të gjitha ato vendbanime që janë me prioritet të lartë, por na dele pastaj një situatë kështu: P. sh për trotuare nuk munden të përmenden sepse në 33 fshatra, qyteti dhe 2 vendbanimet kanë nevojë për trotuare, nëse e përmend një fshatë atëherë do të dilte qesharake situata. Ne e kemi bërë incizimin e gjendjes komplet dhe ne e dimë saktë se ku ka nevojë për ndërtim të trotuareve, ose ku ka nevojë për përmirësim të kanalizimeve, ku ka nevojë për ujë të pijes, ku ka nevojë për rrugë dhe rrugica. Nëse hymë me kode të reja sot i përmendim, por ekziston mundësia që ne të hymë me një tunel të pafund, gati në çdo pozicion ka nevojë për rrugë, trotuare kanalizime etj. të nderuar të gjitha rrugët dhe trotuaret e komunës së Rahovecit janë përfshirë, natyrisht flasë ato që janë më me prioritet. Kodi i përgjithshëm duhet të mbetet sepse ne nuk mundemi me e bë Rahovec kjo, kjo, kjo rrugë do të shtrohet, kjo nuk mundet të bëhet sepse gati çdo vendbanim siç e dini edhe ju çdo ku ka nga një kërkesë, kurse të gjitha janë dikur rreth 15 kode të reja.

Përparim Krasniqi – Të nderuar projektet që e kanë kodin përpara nuk mundemi me ndërhy aty sepse janë kode në vazhdimësi, kurse sa i përket projekteve të reja po ju flasë vetëm për ndërtimin e rrugëve në komunën e Rahovecit. Ne e kemi listën e të gjitha vendbanimeve dhe qyteteve se sa rrugë do të ndërtohen, në qytetin e Rahovecit janë adresuar 22 rrugë ku e kapë shifrën diku 300,000.00 €, vetëm në qytet flas, por ne i kemi përzgjedhur vetëm dy rrugë, rruga “Tafil Zymberaj”, Pastaj në Pastasel e kemi rrugën tek lagja e Merselëve, rruga në Polluzh që e lidh shkollën me urë, dy rrugë në Xërxë sepse nuk ka pasur investime sa duhet në këtë fshat, rruga tek hekurulla dhe rruga “Nëna Terez”, rruga në fshatin Zoqishtë rruga Samerdanit, këto janë disa prej rrugëve që kanë filluar fazën e kontraktimit dhe këtë vit do të fillohet të punohet. Sa i përket trotuareve e kam listën e të gjitha vendbanimeve, në Malësi të Vogël janë edhe pesë rrugë, janë me emërtime të matura të gjitha por këtë vite ne nuk guxojmë ta tejkalojmë shifrën prej 360,000.00 €. Projekti ndërtimi i rrugëve, janë diku 39 rrugë me kontratë që i kemi trashëguar nga viti 2017 dhe që janë në fazën përfundimtare, teprica ka nga ky kod rreth 60,000.00 €, këto mjete i kemi planifikuar për këto 9 rrugë të reja që të vazhdoj projekti në vitin 2019, ne kemi kërkesa për ndërtim të rrugëve në vlerë prej 1,200,000.00 €, por ne nuk guxojmë prandaj i kemi zgjedhur 9 rrugë që janë me prioritet të lartë. Sa i përket trotuareve këtë vite kanë filluar janë në fazën e kontraktimit, në Celin nga rruga kryesore deri tek shkolla, Fortesë nga rruga kryesore deri skaj rrugës Sapniq – Pataqan, Malësi e Vogël parkingu i AMF-së, parkingu i shkollës dhe në anën e djathtë të rrugë aty ku ka hapësirë që të investohet. Ratkoc tek lagja e komuniteteve një pjesë e trotuarit që nuk është trajtuar fare, Drenoc trotuari dhe kanali, ky është njëri ndër projektet më të mëdha në Drenoc i cili ka vlerën mbi 80,000.00 €, ne kemi planifikuar që këtu të jetë kanali i hapur pluse trotuari. Çifllak nga hekurudha në drejtim të shkollës, pra këto janë prioritete të larta të trotuareve, por kemi kërkesa edhe për dy trotuare që do ju tregoj tani, rruga Ratkoc – Vrajak por pa e trajtuar një herë atë rrugë ne nuk mundemi aty ta ndërtojmë trotuarin, pastaj kemi kërkesë për Sopniq një trotuar prej 3 km, ne nuk mundemi me tejkallua vlerën e parashikuar për shkak të kërkesave të shumta. Pra këto janë pjesët kryesore të trotuareve që ne këtë vit i kemi futur në planifikim. Sa i përket kanalizimeve e kam listën prej 16 vendbanimeve: Rahovec ka lagje që nuk ka fare kanalizim dhe ne duhet që ti bëjmë zgjidhje, Brestoc lagja e komuniteteve është një kërkesë për kanalizim sepse nuk kanë fare, Drenoc janë 2-3 lagje pa trajtim të kanalizimit, Senoc është një lagje mbi shkollë, në Krushe të Madhe është lagja e bizneseve pra në rrugën kryesore janë ato biznese të cilat kanë bërë kërkesë dhe nuk kanë fare kanalizime, Zoqishtë është lagja e Gashëve, Fortesë lagja e Zhuniqve, Pataqan i poshtëm tek shkolla janë 2-3 shtëpi që kanë kërkuar kanalizim për arsye se kanalizimi i shkollë është duke i bërë dëme atyre. Ka edhe në Polluzh, Celin, Ratkoc, Pastasel pra janë diku 16 vendbanime siç e thash ne i kemi bërë projektet dhe këtë vite fillojmë.

Mirjeta Krasniqi – Kishte me qenë mirë të dihet se çka do të ndërtohet, prandaj le të futet tek kodi i ri tek kodi për ndërtimin e kanalit për ujërat atmosferikë dhe ndërtimi i rrugëve me kubëza në fshatin Zatriq, pra le të figuroj edhe fshati Pastasel.

Përparim Krasniqi – E nderuar unë ju tregova më parë se ne e kemi futur ndërtimin e rrugës në Pastasel sepse është prioritet i lartë, kurse sa i përket ujit të pijes ne nuk e trajtojmë, ne kemi bërë marrëveshje me KRU- Gjakovën, fazën e dytë janë duke e kryer me Pollzhë dhe Guri të Kuq, pastaj vazhdojnë me Pastasel dh me këtë përfundojnë të gjithë sa i përket ujit të pijes. Nëse mëndini që ti i fusim të gjitha ashtu siç jeni duke propozuar ju mendoj se nuk do të dele as buxheti i Kosovës e leje më i Rahovecit.

Kryesuesi - Mendoj se të gjithë kemi dhënë kontribute dhe mendime tona sa i takon pikës së pestë të rendit të ditës KAB-i 2019-2021. Tani jemi në fazën që duhet ta qesim në votim KAB-in 2019-2021.

Rasim Fazliu – Fillimisht është një procedurë kur dikush propozon diçka të hidhet në votim, unë në fillim të kësaj pike kam propozuar diçka në emër të grupit që të hiqen disa projekt që janë në investime kapitale sepse nuk i takojnë investimeve kapitale, ato i takojnë Mallra dhe shërbimeve dhe në subvencione, prandaj i nderuar ju së pari duhet ta shtini propozimin time në votim. Po ashtu desha të propozoj një pauzë prej 15 minuta, që të mëremi vesh dhe pastaj të kthehemi për të vazhduar mbledhjen.

Kryetari – I nderuar e di që sipas procedurës secili propozim duhet të hidhet në votim, edhe një herë po ju them në emër të qytetarëve të komunës dhe në emër të gjithë juve këtu se kodet e propozuar për projektet të cilat ne besojmë se asnjë problem ligjor nuk kanë në trajtimin e mbështetjes direkt për fermerë në kategori të caktuara, jam tepër i nderuar që kam mbërritur të fusë si kod, për herë të parë komuna e Rahovecit ka filluar që ti ngajë një komune. Unë definitivisht jam kundër si kryetar i komunës së Rahovecit për çfarëdo përpjekje që bëhet për ta hequr ose zhvendosur disa projekte nga kodi i cili ka të bëjë me investime kapitale dhe ti dërgojmë në mallra dhe shërbime. Ta dini se i keni hyrë borxh qytetarëve, fermerëve edhe ashtu janë bukur shumë të dëmtuar dhe bukur shumë ja kanë nevojën komunës së Rahovecit, propozimi le të hedhet në votim sepse është procedurë, jam i vetëdijshëm se të gjithë jemi për miratim të buxhetit por një lëvizje e tillë radikale nuk mendoj se i bënë nderë përkrahjes së fermerëve dhe bujqësisë sonë. I ftoj edhe një herë kuvendarët që të votojnë pro aprovimit të KAB-it 2019-2021 sepse është edhe obligim ligjor, po ashtu i ftoj kuvendarët që pasi të hedhet në votim propozimi për heqjen e disa projekteve nga investimet kapitale që të reflektojnë dhe mos të ja heqin 190,000.00 € nga dora fermerëve tanë.

Fehmi Cena – I nderuari Kryesues para se ta hidhni në votim desha një sqarim, ne i paraqitëm disa kërkesa, ishte njëra edhe nga znj. Mirjeta Krasniqi, ne po dakordohemi por kërkesa për fshatin Pastasel të hyjë në kuadër të planit në kodin e ri.

Kryetari – Në rregull i nderuar, do të përfshihet fshati Pastasel në njërin nga kodet e reja.

Kryesuesi – E qes në votim propozimin e grupit parlamentar të PDK-së që disa kode që janë përfshirë në investime kapitale të hiqen nga ky kod dhe të barten tek mallrat dhe shërbime dhe tek subvencionet: Konstatoj se me shumicë votash kundër nuk aprovohet propozimi i z. Rasim Fazliut. Të nderuar e qes në votim Propozim vendimin të Buxhetit si dhe KAB-it për vitin 2019 – 2021: Konstatoj se me 17 pro, 3 kundër dhe 8 abstenime, aprovohet KAB-i 2019-2021 i Komunës së Rahovecit. Kalojmë në pikën e radhës:

6. Informatë nga DKA-ja për fillimin e vitit të ri shkollor 2018/2019.

Avni Morina – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, Drejtoria Komunale e Arsimit gjatë gjithë muajit të fundit ka punuar dhe ka bërë të gjitha përgatitjet e duhura për një fillim të mbarë të vitit të ri shkollor 2018/2019. Në fillim të muajit gusht, kemi analizuar me kujdesin më të madh gjendjen e personelit mësimor në të gjitha shkollat e komunës sonë, duke bërë një planifikim dhe një ri sistemim të kuadrit mësimor sipas profileve mësimore në të gjitha nivelet, duke filluar nga niveli para fillor e deri tek niveli i mesëm i lartë. Si rezultat i planifikimit të bërë, kemi pasur edhe një konkurs për plotësimin e vendeve të lira në 14 pozicione në shkollat e komunës, shumica e të cilave ishin zëvendësime, pra pozita me kohë të caktuar. Vlen të theksohet fakti se për këto 14 pozita mësimdhënësish dhe edukatorësh, në këtë konkurs kanë

aplikuar 123 kandidatë. Drejtoria Komunale e Arsimit ka marrë të gjitha masat që procedura e konkursit të shkojë mirë, duke respektuar të gjitha afatet ligjore dhe udhëzimet administrative të MASHT-it. Ky konkurs u hap në përputhje të plotë me Udhëzimin më të ri Administrativ 10/2018, i cili hyri në fuqi më 20 korrik 2018. Vlen të theksohet fakti se jemi ndër komunat e vetme, që ky konkurs nuk u anulua nga Inspektorati i Arsimit, sepse në shumë komuna ka ndodhur anulimi i konkurseve, përshkak të faktit se ato komuna nuk kishin hapur konkurse sipas udhëzimit më të ri administrativ, të cilin ne e kemi marrë parasysh sapo ai hyri në fuqi nga Ministria e Arsimit. Gjatë muajve të verës u mbajtën edhe një varg trajnimesh me arsimtarë e mësimdhënës të fushave të ndryshme kurrikulare, të cilat ishin të nevojshme për ngritjen dhe përgatitjen edhe më të mirë profesionale të mësimdhënësve tanë. Trajnimi i fundit ishte me grupin e Gjuhëve dhe Komunikimit. Në fund të muajit gusht, nga Ministria e Arsimit kemi pranuar të gjitha librat/tekstet shkollorë për klasat 1 deri 9, të cilat fillimisht i kemi vendosur në pikën grumbulluese dhe pastaj ato i kemi shpërndarë në të gjitha shkollat fillore të komunës sonë. Fillimi i Vitit të Ri Shkollor si në mbarë Kosovën, edhe tek ne ishte më 3 Shtator, ditë e hënë, dhe që në fillim, të gjitha SHFMU-të komunës sonë ishin të pajisura me tekste shkollorë, mirëpo kemi disa tekste të lëndës së gjuhës gjermane për klasat e 6-ta dhe të 7-ta, të cilat Ministria e Arsimit i ka vonuar dhe ende nuk janë shpërndarë. DKA ka grumbulluar të gjitha kërkesat e shkollave për lëndë djegëse që do të përdoren për ngrohje gjatë muajve të dimrit, por me vendimin e Ministrisë së Arsimit të datës 20 korrik 2018, është ndaluar përdorimi i thëngjillit në të gjitha institucionet edukativo arsimore. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, DKA ka kërkuar nga Zyra e Prokurimit që të ndalojë procedurat e prokurimit për thëngjill si lëndë djegëse. Në bashkëpunim me Zyrën e Prokurimit jemi kujdesur edhe për procedurat e prokurimit për lyerjen dhe mirëmbajtjen e shkollave, por për arsye të zgjatjes së këtyre procedurave ka pasur vonesa në realizimin e kontratave për lyerje dhe mirëmbajtje të objekteve shkollorë. Me keqardhje duhet t'ju themi se trendi i rënies së numrit të nxënësve edhe këtë vit është shumë i madh. Kështu, sipas evidencave të nxënësve të regjistruar në këtë fillim viti shkollor, në shkollat e mesme kemi 226 nxënës më pak, në shkollat fillore të mesme të ulëta 407 nxënës më pak, ndërsa në edukimin para fillor 102 fëmijë më pak. Gjithsej në nivel komune, në këtë vit shkollor kemi 738 nxënës më pak. Zvogëlimi i numrit të nxënësve ka shkaktuar probleme sepse ka ndikuar edhe në zvogëlimin e numrit të klasave dhe për pasojë edhe zvogëlimin e normave të mësimdhënësve. Ne kemi qenë dhe jemi vazhdimisht në kontakt të përhershëm dhe në vizita në shkolla dhe sipas të gjitha të dhënave që kemi, procesi mësimor ka filluar mbarë në të gjitha shkollat. Drejtoria Komunale e Arsimit ka bërë gati një plan me një varg aktiviteteve dhe fillimisht kemi filluar vizitat dhe takimet me Këshillat e Arsimtarëve në të gjitha shkollat. Që nga fillimi i vitit shkollor e deri më tani kemi realizuar takime me Këshillat e Arsimtarëve të 5 shkollave. Në këto takime kemi kërkuar dhe do të kërkojmë vazhdimisht mirëfunksionimin e organeve drejtuese të shkollave dhe ngritjen e nivelit të përgjegjësisë të të gjithë mësimdhënësve dhe drejtuesve të shkollave. Vizita të këtilla nëpër shkolla do të ketë vazhdimisht sepse synojmë që sistemin arsimor të komunës sonë ta ngrisim në një nivel më të lartë, që siguron arsim cilësor.

Kryetari – Ju falënderoj të gjithëve për një kontribut të përbashkët në adresimin e çështjeve që lidhen me KAB-in, falënderoj të gjitha ata kuvendar që e votuan, por edhe ata që e votuan kundër falënderoj. Të nderuar kam gabuar kur e kam thënë se buxheti për bujqësi në komunën e Rahovecit do të jetë 1 milion, sepse tani është mbi 1 milion buxheti për bujqësi, mendoj se ky është lajmi i mirë për bujqit e komunës së Rahovecit. I nderuari z. Sali Sallteku më tha se do ta kem të vështirë, por të nderuar unë asnjë punë nuk i frikohem, gjithmonë ballafaqohem me punë dhe bashkërisht kemi me i tejkalua këto punë, dhe ju siguroj se do të dilni të kënaqur të gjithë ju që jeni në kuvend, e në radhë të parë qytetarët e komunës së Rahovecit.

Sali Sallteku – Nuk kam asgjë kundër që ka kaluar buxheti ka qenë qysh ka qenë qëndrimi i partisë sonë, nuk e thash që je duke mu dhimbsur sepse nuk e kam atë vesfese sepse nuk më dhimbsesh fare. I gëzohem këtij votimi sepse e di çka do të thotë të i humbësh 1 milion euro, nuk kam dashur të ju them por ja që tani do ju them, ju i nderuar jeni kryetar vetëm i AAK-së e jo i të gjithë qytetarëve të komunës. Është dashur të i

marrësh edhe këta që të votuan të i shtiesh në rreth me ty, sepse këta u bënë të mirë dhe ta votuan buxhetin, ndaja edhe atyre nga një copë bukë.

Kryetari – Të nderuar me mandat jam kryetar i zgjedhur i komunës së Rahovecit dhe jam i zgjedhur drejtpërsëdrejti me votat e qytetarëve, po ashtu jam kryetar i AAK-së dega në Rahovec dhe për këtë jam krenar. I nderuar e bëjë punën në interes të qytetarëve si kryetar komune, kurse mos të harrojmë se unë i shërbej qytetarëve të komunës së Rahovecit dhe sukseset e dikujt mua nuk më pengojnë, edhe në të ardhmen kur nuk do të më pengojnë, çdo punë e suksesshme që është bërë deri më tani në këtë komunë do e vlerësoj, kurse nga kjo ditë e deri në shtatorin e ardhëm po ju japë fjalën se nuk do i fali gabimet e askujt, mos harroni se unë di shumë gjëra që lidhen me qeverisjen edhe pse nuk dua të flasë. Ndërsa kur të më gjeni mua ndonjë gabim ja ku më keni, nuk do iki asnjëherë, por lista e aktiviteteve që nuk ju bënë nderë as juve z. Sali Sallteku sepse keni qeverisur edhe ju 4 vite me komunën e Rahovecit, është shumë e gjatë.

Vjosa Sylka - Desha të flas rreth fjalimit që e dha drejtori i DKA-se i cili e tha që konkursi i shpallur dt. 20.07.2018 sipas tij qenka ligjor dhe në rregull, mirëpo unë dua ta ri 'përsëris që ky konkurs nuk është ligjor, ky konkurs i është referuar U.A. 10/2018 , i njëjti U.A, në kohën e shpalljes se konkursit nuk ishte në fuqi, por në fuqi ishte pikërisht U.A. MASHT Nr. 06/2015. Sa i përket hyrjes në fuqi të U.A.10/2018 nëse e lexoni nenin 15 të U.A. 10/2018 e vëreni se i njëjti është nënshkruar me 20.07.2018. Kur flisni për cilësinë në arsim, nuk e di për çfarë cilësie flisni ju, pasi që punësimi i stafit të mësimdhënësve nga ana juaj është bërë me kriter të vetëm e ai është klientelizmi.

Fehmi Cena – Desha të i përgjigjem parafolësit që ndërlidhet me atë që e tha kryetarit meri edhe këta afer vete, i nderuar LDK-ja është pari shtet formuese, ne punojmë dhe angazhohemi për shtet e jo për pushtet.

Kryesuesi – Të nderuar kuvendar me kaq përfundon mbledhja e sodit, ju falënderoj të gjithëve për kontributin e dhënë, mirupafshim në mbledhjet e radhës.

Mbledhja e kuvendit ka përfunduar në ora 15:45

01 Nr. 2915

Rahovec, 26.10.2018

Procesmbajtësi

Skender Hamza

